

*Master Profesional në Politika dhe Administrim / Drejtim Turizmi*



Tema “ Zhvillimi i turizmit malor në Shqipëri “

Punoi : Arjol Haxhillari.

Petagogu udhëheqës I temes:

Msc.Hysni Ahmeti

Data 15.1.2013 Durrës.

Mirnjohje.

Të qënurit student në Universitetin Aleksandër Mojsiu më ka motivuar mjaft për një të ardhme më të mirë. Dega e turizmit më ka pëlqyer gjithmonë pasi në të gjen një sërë elementësh të cilët ,më kanë plotësuar në karjerën time .


Petagogët e këtij universiteti me përkushtimin e tyre ma kanë bërë më të lehtë ,për ta kuptuar këtë profil të ekonomisë .

Falenderoj të gjithë stafin petagogjik të cilët kanë qënë gjithmonë të gacëm të mëndihmojnë , në vështirësitë e hasura gjatë ciklit studimor.

Një mirnjohje e madhe I shkon gjithë stafit drejtues dhe jo vetëm pasi në saj të punës së tyre ata po tërheqin cdo vit një numur të knsiderushëm studentësh , të cilët do të jenë në të ardhmen burime njerëzore të kualifikuar pasi dihet që në këtë fushë Shqipëria ka mangësi të mëdha.

Përfundimi I këtij masteri profesjonal do të më ndihmojë në karjerën time në fushën e turizmit në tëardhmen .

Ju faleminderit.



## Struktura

### Kapitulli I Hyrje

### Kapitulli II Historiku I zhvillimit të turizmit në Shqipëri

2.1 Turizmi si degë e ekonomisë.

2.2 Analiza Sëot e turizmit në vëndin tonë

2.3 Zbatimi I strategjive në turizëm.

2.4 Sfidat kryesore drej një turizmi të qëndrueshëm

2.5 vizjoni 2013

### Kapitulli III Turizmi malor

3.1 Faktorët që ndikojnë në tërheqjen turistike të turizmit malor në vëndin tonë.

3.2 Vëndet në të cilat mund të zhvillohet turizmi malor.

3.3 Parqet kombëtare dhe natyrore si vlerë e pa zëvëndësushme për turizmin.

3.4 Pse turizmi malor është shumë pak I zhvilluar krahasuar me atë të plazhit dhe djellit.

3.5 Turizmi malor në Shqipëri përballë konkurentëve.

### Kapitulli VI Thelli si një nga destinacionet më të preferuara për turizmin malor.

4.1 Historiku ,pozita gjeografike dhe klima e Thethit.

4.2 Vlerat e Thethit dhe ndikimi I tyre në zhvillimin e turizmit.

4.3 Problemet që hasen në zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

4.4 Analiza swot .

## Rekomandime

## Përfundime

## Bibliografi

## Abstrakt

Ky punim u krijua me qëllim që të tregojë të gjitha burimet natyrore ,kulturore që janë pjesë e turizmit malor në vëndin tonë , si një ndër degët kryesore të turizmit.

Ky lloj turizmi pritet të ketë një zhvillim të madh në të ardhmen pasi 2/3 e sipërfaqes totale të vëndit e zënë pjesët malore.

Ky punim përvec tregimit të burimeve dhe potencjalin e madh , nga ana tjetër nxjer në pah edhe mangësit dhe rekomandimet të cilat duhet të vihen në zbatim sa më tarë të jetë e mundur , pasi fqinjët tanë Maqedonia dhe Mali i ZI kanë tashmë një kulturë dhe infrastrukturë të ngritur në këtë degë të turizmit.

Uroj që masat e marra nga qeveria për lehtësirat fiskale të mos keq përdore ( sic ka ndodhur me zonën bregdetare ) port ë jenë të kontrolluara dhe të monitorohen vazdimisht .



## The abstract

This work is made in order to show all the natural and cultural resources that are part of the mountain tourism in our country as one of the main branches of the tourism which is going to be develop in the future because 2/3 of our territory is with mountains. This work except the resources shows also the problems and the recommendations which should be practice as soon as possible because our neighbors like “Macedonia or Montenegro” has already a infrastructure and culture in this kind of tourism.

I hope that the measures that were taken from the government for the fiscal facilities should not be used in a bad manner and should be strictly controlled from them.



## Kapitulli I Hyrje

Turizmi mund të mendohet si një bashkësi lidhjesh dhe fenomenesh që vijnë si rezultata i lëvizjes dhe qëndrimit të përkoshëm të njerëzve që udhëtojnë nga njëri vënd në tjetrin. Kjo lëvizje mund të jëtë e drejtuar nga element argëtues njohës etj. Në ndryshim nga të mirat e tjera të konsumit oferta turistike nuk mund të transportohet por ajo konsumohet në vëndin turistik. Turizmi tashmë është afirmuar si një dukuri tipike e qytetërimit të sotëm. Ajo cka parashikohet në të ardhmen është ritja e shkallës së ineresit të kësaj dukurie nga ana e bizneseve private, shoqatave , inicjativave shoqërore, popullatës dhe kjo për vetë faktin e rëndësisë ekonomike shoqërore dhe psikologjike që ajo sjell. Roli dhe rëndësia e turizmit në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të një vëndi shprehët nëpërmjet vlerësimit ekonomik si dhe burimeve natyrore dhe kulturore të tij. Gjatë perjudhë së komunizmit shqipëria ka qënë një vënd i izoluar nga bota për rreth 50 vjet. Ky faktor ka pëcaktuar pamundësinë për tu integruar në nivele ndërkombëtare, por nga ana tjetër ajo ka sjell edhe zhvillimin dhe ruajtjen e traditës në vëndin tonë , ndërkohë që pjesa më e madhe e botës po shkonte drejt rrugës së globalizimit. Me luginat lumenjtë mallet, bregdetete Shqipëria paraqet tek ata të cilët e vizitojnë një larmi të pa besueshme pejsazesh. E shkuara dhe e ardhmja e këtij vëndi bën të mundur që të tërhiqet vëmëndja e turistëve duke e zgjeruar akoma dhe më shume tregun potencial te saj. Evoluimi i turizmit ka qënë disi i ngadaltë , por ky faktor ka ndihmuar në maturimin e zgjedhjeve dhe forcimin e kalimit nëpër fazat te ndryshme të zhvillimit turistik. Tashmë ndodhemi në fazën e angazhimit të popullsisë lokale në inisjativat e investimeve në fushën e turizmit , të cilat i shtohen preokupimit potitik e qytetar per të përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën e nevojshme.

Nga ana tjetër

turizmi është kthyer në një temë jo vetem ekonomike por edhe politike. Vëndi ynë sot përbën një ofertë fantastike për turistët pasi ka në përbërjen e saj gjithçka mund të kërkojë. Dhe jo vetëm kaq, por në rradhë të parë gjen mikpritjen shqipëtare dhe gatishmërinë për të ofruar gjithçka kanë. Mbetet ende shum punë për të bërë në disa dretime kyce në të cilat vëndi ynë ka mangësi të theksuara si janë burimet njerëzore të kualifikuara në këtë fushë, investimet ,si dhe poltikat drejtuese .

Përpjekjet e para

janë duke u bërë si prsh në disa universitete ne vënd janë hapur profilet e turizmi si degë studimore , investimet cdo vit po njohin rritje si dhe është hartuar legjislacjoni për turizmin dhe zhvillimin e tij.

*Kapitulli II Turizmi si degë e ekonomisë në Shqipëri.*

Gjithnjë e më shumë turizmi po shndërohet në furnizuesin kryesor të ekonomisë me të ardhura. Mirëpo zhvillimi spontan i pa mbështetur në strategji të qarta, nuk mund të shndërohet në një mjet të qëndrueshëm për të garantuar rritme të larta rritjeje.

Në vëndet në të cilat zhvillohet turizmi sjell mjaft aspekte positive ekonomike si rritje ekonomike, rritje e punesimit ne këtë sektor për pasoj rritje të të ardhurave rritja e investimeve vëndase dhe të huaja.

Tabela.nr 2.1 Te dhena për flukset e turisteve nder vite.

| Nr.             | PERIUDHA | VIZITORE TE    |                |                |                |                |
|-----------------|----------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
|                 |          | HYRE           | 2007           | 2008           | 2009           | 2010           |
| 1               | Janar    | 49437          | 55635          | 58640          | 68997          | 90712          |
| 2               | Shkurt   | 41173          | 52284          | 52787          | 55181          | 79189          |
| 3               | Mars     | 53532          | 68942          | 62933          | 72864          | 106649         |
| 4               | Prill    | 70040          | 76867          | 98735          | 90139          | 145171         |
| 5               | Maj      | 77577          | 97995          | 113362         | 117261         | 146114         |
| 6               | Qershor  | 93533          | 123249         | 135740         | 144663         | 196704         |
| 7               | Korrik   | 201428         | 251926         | 469109         | 565262         | 670713         |
| 8               | Gusht    | 215120         | 257185         | 411252         | 711546         | 684886         |
| 9               | Shtator  | 95148          | 101461         | 119358         | 158545         | 200486         |
| 10              | Tetor    | 75109          | 91319          | 100783         | 128452         | 149917         |
| 11              | Nentor   | 54994          | 65691          | 73165          | 95288          | 122986         |
| 12              | Dhjetor  | 71674          | 87584          | 90181          | 94701          | 140123         |
| <b>GJITHSEJ</b> |          | <b>1098765</b> | <b>1330138</b> | <b>1786045</b> | <b>2302899</b> | <b>2733650</b> |

Nga të dhënat vërehet qartë se numri i turistëve në vëndin tonë po rritet ndjeshmë vit pas viti. Por nga ana tjetër vërehet edhe një fakt jo shumë pozitiv sic është sezonaliteti i cili vërehet qartë pasi numri me i madh i vizitorëve në vëndin tonë vërehen gjatë perjudhës korrik dhe gusht kjo është karakteristike e të gjitha viteve. Muajt më pak të frekuentuar për të bërë pushime janë ato të janarit dhe shkurtit. Kjo tregon se në vëndin tonë ende dega dominuese në turizëm është ai i plazheve dhe djellit duke lënë mënjanë turizmin malor me shume pak turistë e sidomos në stinën e dimrit.

Vendi ynë ka 1350 fshatra ku jetojnë afro 1 milion njerëz. Ky fakt përbën një oportunitet për zhvillimin e turizmit rural veçanërisht agroturizmin, ekoturizmin, turizmit natyror etj. Kjo është

përcaktuar edhe si një nga objektivat kryesore që synojnë politikat e qeverisë duke nxitur dhe përkrahur krijimin e strukturave pritëse tradicionale në zonat rurale sidomos në zonat e thella malore dhe duke orientuar investimet drejt përmirsimit të infrastrukturës në këto zona. Qëllimi kryesor është diversifikimi i produktit turistik që ofron vendi ynë, bazuar në burimet turistike, pasurimi i itinerareve turistike sipas kërkesave të kategorive të ndryshme të turistëve, si dhe përmirsimi i nivelit ekonomik të komuniteteve pritëse sidomos në ato rurale është edhe zhvillimi ekonomik i komuniteteve rurale në sajë të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike. Produkti qëndror i Shqipërisë do jetë “ zbulimi” i saj. Produkti është një prezantim dhe një prerje tërthore e përgjithshme e historisë, natyrës, arkeologjisë, kulturës së jetesës, kuzhinës dhe mikpritjes së Shqipërisë.

Këshili Botëror i Turizmit.

Mbi bazë të të dhënave të Këshillit Botëror të Turizmit sektori i turizmit në vëndin tonë po zë një rol kyc në kontributin që ajo jep në PBB, me 81.4 miliard lek e cila përkon me afro 6.2 % të totalit të tij.Parashikimet për të ardhmen janë mjaft positive pasi ato mendohet që të rriten cdo vit me 5.4 % të ardhurat në produktin e brëndëm bruto deri në vitin 2022 do të jenë afro 145.4 miliard lek. ".

Nga ana tjetër, ekspertet e Keshillit Botëror të Turizmit kanë marrë në analizë edhe treguesin e punesimit direkt në sektorin e udhetimeve dhe turizmit, i cili, sipas tyre, nga 51.000 vende pune (rreth 5.5% e punesimit total) që zuri vitin e kaluar, sivjet për ta ka një pritshmeri rritje prej 4.3%.

Madje, ata shkojnë edhe më larg, duke bërë llogaritë për gjithë dekadën e viteve 2012-2022, përgjate se ciles, sipas tyre, numri i të punësuarve në këtë sektor, do të arrijë deri në 70.000 të tilla, duke zënë kështu 6.5% të punesimit total.

E kompletuar me të tilla shifra pozitive, duket se Shqipëria zë një vend të mirepozicionuar mes 183 vendeve të botes, të marra në shqyrtim nga organizimi i njohur i Keshillit Botëror të Turizmit, mbi kontributin real që ky sektor po jep në PBB-ne e saj dhe tregues të tjere të rëndësishëm të ekonomisë vendase, si punësimi, investimet etj.

Investimet e realizuara në industrinë shqiptare të turizmit dhe udhetimeve, këtë vit parashikohet që të njohin një rritje të konsiderueshme, deri në nivelin prej +7.5.



Kete e konfirmojne te dhenat me te fundit te Keshillit Boteror te Turizmit, i cili shkon edhe me larg, duke llogaritur investimet qe do te kryhen ne total per kete sektor ne vendin tone, deri ne vitin 2022. Sipas tij, ato do te shenojne nje rritje me norme mesatare prej 4.6% gjate kesaj dekade duke kapur shifren totale prej 35.4 miliarde lekesh ne vitin 2022. Kujtojme ketu, se per vitin 2011, Shqiperia shenoi nje total investimesh ne vleren prej 21 miliarde lekesh

## 2.1 Historiku i zhvillimit të turizmit në Shqipëri

Vendi ynë shpesh herë ka qënë një haren lufrash dhe konfliktesh kjo për shkak edhe të pozitës gjeografike që ai ka, dhe për këtë arsye në të nuk ka patur një zhvillim të mirfilltë të turizmit. Rëndësia e kësaj dege të ekonomisë është kuptura tepër vonë. Deri në vitin 1945 kjo gjëndje kautike politike, sociale por edhe ekonomike nuk lejoi zhvillimin e turizmit. Përpjekjet e paka filluan të dukeshin pikërisht në këtë perjudhe megjithese shumë të vogla. Kështu Shqipëria në këtë perjudhe ka qënë qëllim i vizitorëve dhe turistëve të cilët ishin të vegjël në numur. Vëndet më të preferuar prej tyre ishin Plazhi i Durrësit liqeni i Pogradeci, për turizmin e plazhit dhe të djellit, vëndet me një klimë shumë të mirë si Saranda dhe Korca si dhe Kruja si vënd i cili mbar historit të gjatë dhe mjaft të lashtë. Në vitin 1929 nga të dhënat dalin se në Shqipëri kishte 27 hotele gjithjes, ku tre prej tyre ishin të vendosur në zonën e plazhit të Durrësit. Gjithashtu hotele të tjera të ndërtuara në këtë perjudhë që i rezistojnë ende kohës janë : hotel “DAJTI “ në Tiranë dhe hotel “ Adriatiku “ në Vlorë të dyja zotërojnë stilin italkan të ndërtimit. Me mbarimin e kësaj perjudhe të pa qëndrueshme vendi ynë kishte premise të mira për të zhvilluar turizmin, por fatkeqësisht me ardhjen në pushtete të rregjimit socialist dhe politikave të tyre izoluese , nuk e nxiti zhvillimin e turizmit por përkundrazi e pengoi atë duke i dhënë më shumë rëndësi zhvillimit të degëve të tjera të ekonomisë si asaj të industrisë së rëndë .

Turistët e ardhur në këtë perjudhë sigurisht që ishin të pakët në numur. Ata ishin të ardhur nga Europa Lindore me të cilën Shqipëria kishte mardhënje të mira politike, turistët e vëndeve të tjera nuk mundën ta vizitonin Shqipërinë në këtë perjudhë. Pas vizitës së Hurshovit në Shqipëri , u vërej një fluks më i madh turistësh në vëndin tonë sidomos nga vëndet ish Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1958 u ndërtua dhe u vu në shfrytëzim hoteli turistik Adriatik I Durrësit I cili ishte deri në vitin 1990 i vetmi hotel internacjonal që mund të përdorej nga turistët e huaj. Për turistët e vëndeve të Evropës Perëndimore Shqipëria gjatë gjithë perjudhës 1960- 1990 do të ishte e kufizuar për tu vizituar. Trajtimi i turizmit si një degë me rëndësi ekonomike sin ë vëndet e tjera

të mesdheut ishte e pa mundur. Drejtuesi kryesor i cili përcaktonet se në çfarë mënyre do të drejtohej dhe zhvillohej turizmi ishte vetë shteti I cili ishte në formën e një monopoli drejtues. Turizmi nuk do të cilësohej si një sektor i rëndësishëm ekonomik por si një sektor ideologjik , gjë e cila do ta kufizonte atë si nga ana cilësore ashtu edhe nga ajo sasiore. Kështu e vetmja formë e organizimit të turizmit ishte ajo e organizuar në grupe udhëtimi me jo më shumë se 20 pjesmarrës. Ndërsa udhëtimet individuale apo ato të organizuara nga vetë turistët e huaj ishin kategorikisht tënadaluar .Ofertat turistike kishin në fokus të tyre vetëm informimin .Pas mbarimit të sezonit veror e vetmja formë udhëtimi ishte ,ajo në kuadrin e vizitave të organizuara të qyteteve më interesante shqipëtare ku turistët vizitonin kryesisht qytetet jugore dhe juglindore,ndërsa qytetet në veri të vëndit fillua relativisht vonë të vizitoheshin nga turistët.Turizmi në Shqipëri përgjatë perjudhës së sundimit komunist njohu një zhvillim fare të vogël dhe mjaft të politizuar.Pas vitit 1990 me ndryshimet politikike dhe ekonomike në vëndin tonë, turizmi filloi te vlerësohej si një nga degët ekonomike të vëndit e cila përbënte një perspektivë të madhe.Në vitin 1990 -1991 Shqipëria braktisi sistemin e izoluar dhe të gjatë komunist dhe u përfshi në një perjudhë trazicjoni.Në këtë perjudhë ekonomia në vëndin tonë po kalonte , vështirësi mjaft të mëdha të kalimit nga një ekonomi e centralizuar në ekonominë e tregut.

Pasojat e këtij ndryshimi të shumë pritur ishin mjaft të mëdha në të gjithë vëndin e cili u pushtua nga një kaus socjale ekonomiko politike , e cila do të linte gjurmë të mëdha edhe mbas shumë vitesh.

Në vitin 1997 më rënjen e firmave piramidale në vëndin tonë u krijua sërisht një kaus socjal ekonomik dhe politik i cili gjithashtu nuk lejo zhvillimin e turizmit.Situata e vështirë dhe e pa sigurt që u krijua në Shqipëri uli ndjeshëm, prishi mjaft imazhin e vëndit në botën e jashtme dhe largoi shumë turistë që tregonin interes për të vizituar Shqipërinë.

Tabela nr.2.1.1 numri vizitoreve ne total .

|      |           |     |
|------|-----------|-----|
| 1997 | 19.154    | 2.4 |
| 2012 | 1.250.000 | 5.9 |

| Vitet | Turistë gjithsej | Kohëqëndrim ( ditë ) |
|-------|------------------|----------------------|
| 1956  | 280              | 12.9                 |
| 1965  | 1.203            | 4.8                  |
| 1990  | 29.997           | 2.8                  |
| 1995  | 47.275           | 2.6                  |

Mbas këtyre viteve vëndi ynë po bën përpjekje të shumta për të zotëruar një situatë politike dhe ekonomike të qëndrueshme, por që ende në vënd ka konfliktë dhe çështje mjaft të rëndësishme për tu zgjidhur. Tashmë egzistojë premise për një zhvillim të shumllojshëm të turizmit jo vetmë në organizimin në grup por edhe atij individual dhe familjar. Masa si heqja e vizave, nxitja e sektorit privat në fushën e turizmit , janë masa që sot po nxisin zhvillimin e turizmit. Gjithashtu të programet e partive politike dhe qeverive hartimi i planeve të zhvillimit turistik si degë primare e zhvillimit në vënd zenë vëndin qëndror. Për të aritur një zhvillim më të

lartë duhet një bashkëpunim më i fortë midis qeverisjes qëndrore dhe asja lokale, por nuk mbetete pas edhe individët të cilët meren me këtë fushë .

## 2.2 Analiza Swot e turizmit në Shqipëri

Analiza Swot është një teknikë e fuqishme për të kuptuar katër faktorët që e përbëjnë atë dhe ato ndahen në faktor të brendshëm ku përfshihen fuqitë dhe dobësit dhe në faktorët e jashtëm ku bejnë pjesë mundësitë dhe reziqet. Faktorët e brendshëm të cilët kanë ndikim pozitiv në turizëm krijojnë fuqi për të kurse ata të cilët kanë ndikim negative krijojnë dobësi. Faktorët e brendshëm varën drejtpërsëdrejti nga ne pra qeverisja qëndrore locale dhe banorët e vëndit. Ndërsa faktorët e jashtëm janë janë më kompleks sepse ato shihen në një kuadër më të gjërë përball konkurentëve.

Tabela.nr.2.2.2 Analiza Swot e zhvillimit te turizmit në Shqiperi.

| Faktorët e brendshëm   |   |
|--|---|
| Pikat e forta  | Pikat e dobta   |
| 1.Kombinimi i truizmit malor, bregdetar kulturor.<br>2.Burime të shumta natyrore<br>3.Monumente të shumta kulturore .<br>4.Burime njërëzorë (mosha mesatare e popullsisë 30 vjec )<br>5.Mbëritja në këtë vënd me mënyra të | 1.Infrastruktura e dobët<br>2.Mungesa e prosesjonalizmit.<br>3.Imazi jo i mir nga vëndet e tjera<br>4. Sinjalistikër rrugore e dobët.<br>5.Mungesa e njësive akomoduese me kapacitete të mëdhenj.<br>6.Vështirësi në zbatimi e strategjidhe dhe |

|   |  |
|---|--|
| ndryshme ,ujore, rrugore ,ajror.<br>6.Klima mesdhetare shum e mirë ( afro 300 ditë me djell )<br>7.Ushqimi I larmishëm me gatime unike. | politikave turistike.<br>7.Njohja e ulët nga vëndet e tjera.<br>8.Mungesa e organizmit në shumë aspekte ekonomike politike socjale.<br>9.Poblemi i pronave dhe ndërtime pa leje. |
|---|--|

| Faktor të jashtëm   |   |
|---|---|
| Mundësitë   | Kërcënimet  |
| 1.Egzistenca e vëndeve ende të pa zbuluara.<br>2.Politikat e ndryshme në tërheqjen e investitorëve.<br>3.Zhvillimi i turizmit si dega kryesore e ekonomis.<br>4.Mundësi bashkëpunimi me agjensitëndërkombëtare.<br>5.Zhvillimi dhe marketimi i ofertave turistike.<br>6.Zhvillimi i turizmit të sporteve ujore. | 1.Globalizmi<br>2.Konkurenca mjaft e madhe e sidomos me vëndet fqinje.<br>3.Mungesë stabilitetei politik.<br>4.Zbehja e traditave dhe zakoneve.<br>5.Mungesa e organizhimit të evenimenteve me famë botërore. |

Nga kjo analizë del në pah se vendi ynë ka burime të shumta për zhvillimit të turizmit në një sërë degësh të tij por nga ana tjetër vërehen edhe një sërë mangësish të cilat duhet tu japim një zhgjidhje në mënyrë të menjëhershë, dhe kjo mund të arihet vetëm në rastet ku ne do të hartojme politika turistike të studjuar mbi bazë të gjëndjes aktuale në të cilën ne ndodhemi.

### 2.3 Zbatimi i strategjive në turizëm.

Turizmi është një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare.Strategjia aktuale e zhvillimit të turizmit është miratuar me anë të V.K.M në vitin 2008 dhe është ende në fuqi.Objektivi primar i kësaj strategjie ishte arritja e një numri të konsiderueshëm turistësh me afro 3.5 milion turistë .Nga statistikat e nxjera nga organet përkatëse del se ky numur turistësh jo vetëm qështë arritur( në vitin 2010) por edhe është tejkaluar . Këto tëdhëna megjithëse janë shumë pozitive ende nuk janë të besueshme pas mënyra e përlogaritjes së tyre le ende për të

dëshiruar.  
kësaj strategjie e cila nuk është zbatuar sicduhet .

Tashmë jemi në fazën përfundimtare të

Prioritetet Strategjike janë :

1.Zhvillimi – strukturimi dhe zhvillimi i turizmit dhe produkteve të tij janë prioritete afatshkurtra dhe afatmesme

2.Ngritja e kapaciteteve dhe strukturave institucionale – krijimi i strukturave institucionale në nivel lokal dhe qendror.

3.Financimi dhe krijimi i mekanizmave afatgjatë për zonat natyrore dhe kulturore, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e tyre.

4.Krijimi i sistemit të grumbullimit të të dhënave statistikore si dhe kërkimeve mbi tregun turistik. Ajo që është e rëndësishme është se vendi është ende “autentik”. Shqipëria nuk është një vend i lehtë për tu kuptuar nga tregjet ndërkombëtare. Vendi ynë është kompleks dhe për një të huaj është virtualisht e pamundur të kuptojë dhe të çmojë vendin pa një asistencë të rëndësishme. Zbulimi i Shqipërisë është me interes sidomos për turistët ndërkombëtar të arsimuar, relativisht të pasur .Për më tepër ky segment shpenzon shume për këtë lloj turizmi.

Edhe modeli i tyre i shpenzimeve është i favrshëm për zhvillim pasi ata preferojnë të ndërveprojnë me komunitetet që vizitojnë dhe tentojnë të blejnë shumë nga prodhimet dhe shërbimet që ofrohen në mënyrë lokale. Periudhat tipike e pushimeve për këtë segment janë nga 8 deri në 14 ditë. Gjatë kësaj periudhe synojnë të vizitojnë destinacione të ndryshme zakonisht në blloqe 2 deri 3 ditore në një qendër lokale dhe Shqipëria përshtatet më së miri me këtë.

Në terma operative, vendi ynë është i gatshëm të lëvizë përpara me turizmin e sektorit të tij.

Jemi në fazën më kulmore, ku gjithçka duhet të ndryshojë, ku gjithashtu duhet riparë me syrin e së ardhmes. Legjislacioni te ne është ende në fazën e tij fillestare, ligji turistik, kodi turistik, dispozita të shpërndara në shumë ministri krijojnë vështirësi për zbatimin e tij nga një qendër e vetme. Dhe të gjitha këto nuk mund t’i bëjë një Ministri. Padyshim që jo. Ka ardhur koha për ta parë më mirë mënyrën organizative dhe funksionale të organeve shtetërore në fushën e turizmit

Pikat e pazbatuara në këtë strategji.

1. Mungesa e zbatimit të ligjit (në lidhje me ndërtimet dhe mjedisin).

2. Zhvillimi i paplanifikuar. Jo sipas modeleve të qarta.I paorganizuar në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.I pabazuar në hierarkinë strategji-masterplane-zona për zhvillim-plane

investimi.

3. Mungesa e kontrollit mbi zhvillimet e mjedisit.

4. Mungesa e veprimit të institucioneve sa i përket krijimit të strukturave, politikave, standardeve, klimës së favorshme për biznes, menaxhim inteligjent i tregut, zhvillim produktesh dhe shërbimesh dhe i burimeve njerëzore.

5. Mungesa e bashkëpunimit mes sektorit publik, privat, qendror dhe lokal.

Do të ishte me interes krijimi një ministrie autonome për turizmin. Gjithashtu, krijimi i drejtorive apo sekretarive për turizmin pranë çdo ministrie që ka lidhje me turizmin, si dhe koordinimin e gjithë kësaj pune me njerëz shumë të aftë. Çmilitarizimi i destinacioneve turistike – ishte në programin sektorial të turizmit. Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit të shikojnë mundësinë e krijimit pranë ambasadave apo konsullatave tona jashtë vendit zyrat e turizmit.

2.4 Sfidat e përgjithshme për zhvillimin e turizmit.

Kjo kategori sfidash përfshin të gjitha vendet të cilat hyjnë në tregjet ndërkombëtare.

1. Krijimi i një pozicioni të qartë në një treg të mbipopulluar.

2. Kapërcimi i koncepteve të mëparshme mbi vendin tonë dhe lidhja e botës me Shqipërinë. (perceptimi i përgjithshëm mbi Shqipërinë variojnë nga neutrale në negative)

3. Investimet duhet të planifikohet për periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatadhe duke qënë se suksesi garantohe nga vijueshmëria në mesazhe dhe prania në tregje vit pas viti.

4. Infrastruktura, telekomunikacioni dhe interneti si fasilitete baze në zhvillimin e kërkuar.

5. Kordinimi midis një numri të madh institucionesh qeveritare dhe joqeveritare.

6. Inteligjenca e tregut. Pa njohjen e detajuar të këtyre tregjeve dhe parashikimin e pritjeve dhe dëshirave të segmenteve të synuar Shqipëria rrezikon të humbasë shumë në investime dhe kohë të çmuar.

7. Të dhënat e brendshme. Planifikimi i turizmit pa këto të dhëna lidhur me tregues të ndryshëm dhe pa një sistem të mirë menaxhimi të tyre, është i pamundur.

2.5 Vizjoni i vitit 2013 dhe ai i të ardhmes

Shqipëria është një destinacion turistik i sigurtë, me vlerë të lartë që karakterizohet nga një larmi e pashoqe e atraksioneve natyrore dhe kulturore të klasit botëror në një sipërfaqe të vogël gjeografike, i menaxhuar në një mënyrë të përgjithshme mjedisore e sociale, lehtësisht e mbrtëshme nga tregjet turistike europiane.

Principet udhërrëfyese për realizimin e strategjisë dhe menaxhimin në të ardhmen të zhvillimit të kësaj industrie vlerësohet të jenë :

1. zhvillimi i qëndrueshëm ( qëndrueshmëri ekologjike, sociale dhe kulturore, ekonomike ). Pranimi i këtij koncepti është esencial për të gjithë zhvillimin e turizmit.
2. Përfitimi i komuniteteve lokale duke ndikuar kështu në rritjen e nivelit të jetesës dhe në përdorimin e mekanizmave financiare dhe arritjen kështu të rritjes së burimit të të ardhurave të zonave rurale.
3. Partneriteti. Në kushtet e ndryshimeve të shpejta të tregut, partneritetet në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare janë të nevojshme të jenë të suksesshme me synimin për të qënë konkurues.( “bashkëpunohet për të konkuruar”). Me rëndësi janë edhe partneritetet e sektorit publik me atë privat.

Qëllimi i zhvillimit të turizmit është të rrisë cilësinë e jetesës dhe kjo do të matet dhe vlerësohet lidhur me aftësinë e tij për të përmirësuar mirëqenien e shqipëtarëve. Më shumë turistë nuk do të thotë më shumë zhvillim apo më shumë të ardhura.

Përfitimet e prekshme të dëshiruara nga një strategji e sukseshme turizmi janë: rritja e punësimit, të ardhura shtesë për ekonominë, infrastruktura e përmirësuar dhe rritja e të ardhurave nga taksat për të kontribuar në zhvillime të ndryshme me interes të përgjithshëm.

Përfitime më pak të prekshme përfshijnë: konfirmimin e kulturës lokale dhe të traditave, mundësia për të mbajtur brezin e ri të interesuar për të qëndruar në vend dhe kontaktet ose shkëmbimet me njerëz nga kultura të ndryshme.

### 2.5.1. Vizjoni i së ardhmes

Turizmi malor, do të jetë turizmi i së ardhmes. Shqipëria ka një potencial të jashtëzakonshëm, më të madh se asnjë vend tjetër, për sipërfaqen e saj të turizmit malor. Shqipëria ka masive malore, që rrinin muaj të tere me debore, por që deri para një viti, kanë qenë shumë vështirë për t'u arritur. Turizmi, që gjer sot është bregdetar, ai malor do të jetë turizmi i të ardhmes. Vendi ka


potenciale me te medha, se asnje vend tjetër, për sipërfaqen e tij të turizmit malor. Pushteti qëndror e ka fokusuar vëmendjen tashmë në këtë degë të turizmit, dhe po bën përpjekje që kjo degë të jetë e arritshme si me infrastrukturë, promovim, si dhe lehtësira fiskale për të gjithë ata të cilët do të investojnë në turizmin malor duke i përjashtua për afro 7 vjet nga detyrimet fiskale

### Kapitulli III Turizmi malor

Turizmi malor në Shqipëri vlerësohet si një nga resurset turistike, më të mëdha të vendit krahas turizmit bregdetar dhe tërheq cdo vit turistë vendas dhe të huaj. Po bëhen përpjekjet e para në përmirësimin e infrastrukturës, dhe sigurisë në këtë sektor, kjo ka sjell shtimin e të ardhurave për banorët e këtyre zonave, operatorëve të ndryshëm turistik, dhe e gjitha kjo ka ndikuar në rritjen e ekonomisë së vendit. Natyra Shqipëtare është e mbushur me një larmishmëri pesazesh malore që fillojnë që nga lartësi të vogla dhe deri në lartësi të mëdha, ato zenë një pjesë të konsiderueshme në sipërfaqen e vendit. Por këto zona përveç bukurive natyrore mbartin edhe një histori të lashtë tradita dhe vlera të trashëguara me fanatizëm.

Këto elemente e bëjnë turizmin malor më atraktiv, më mundësi të jashtëzakonshme turistike. Turizmi malor fillon me Lumin e Valbonës që formohet nga liqenet akullnajore dhe nga shkërrja e bëborës së përjetshme në Alpe dhe më pas filtrohet nën gurët e shtatit të lumit dhe nis rrjedhjen e saj sipërfaqësore. Veprimet turistike janë të shumta fillojnë me turizmin e bardhë gjatë stinës së ftohtë të vitit dhe pasohet me turizmin e gjelbërt që zhvillohet gjatë stinës së ngrohtë.

Fig nr .3.1 Turizmi malor dhe çfarë ai ofron.





Zona kryesore për zhvillimin e sporteve dimërore është pika malore e Voskopojës e cila ndodhet në rrethin e Korçës. Por edhe Dardha e kësaj zone bëhet mjaft tërheqëse. Zhona të tjera ku mund të zhvillohen sporte dimërore janë Alpet Shqipëtarë në Razëm e Theth , Grabovë në rrethin e Gramshit etj.

Të lakmueshme nga turistët gjithashtu janë : mali i Tomorrit në rrethin e Beratit, Vithkuqi Voskopoja , Drenova , në rrethin e Korçës Guri i Kamjes në rrethin e Pogradecit, Llogaraja në rrethin e Vlorës, Korabi dhe Radomira në rrethin e Dibrës, Gjinari në rrethin e Elbasanit etj. Shqipëria gjithashtu ofron kushte të shkëlqyera topografike dhe natyrore për zhvillimin e sporeve ajrore. Pika më e favorshme është Qafa e Llogarasë në një latësi 1.052 metra mbi nivelin e detit. Por pika të tjera ku ushtrohen këto sporte janë: Morava në rrethin e Korçës , Biza e Dajti në Tiranë. Teritoret malore janë tërheqëse për ndërtimin e kampingjeve dhe akomodimin me cadra gjatëstinitës së ngrohtë. Pika të tilla janë : Biza në rrethin e Tiranës , Llogaraja në rrethin e Vlorës, Razma në Alpe, parku i Qafë Shtamës në rrethin e Krujës, Lura në rrethin e Dibrës. Me prezencën e lumenjëve dhe luginave në këto zona është e mundur që të zhvillohet sporti i peshkimit. Zonat më të pështacme për të kryer këtë veprimtari janë përroi i Thethit, lugina e Valbonës, lumi I Matit, lugina e sipërme e Vjosës etj.

Por nuk mbeten pas as shpellat të cilat janë përdorur si vendbanime në parahistori. Ato mbartin me vete një histori menyrë jetëse. Shpellat janë të shumta në zonat e sipërpërmendura. Ndër më interesantet është shpella e Pëllumbasit ose sic quhet ndryshe Shpella e Zezë që gjendet 25 km në juglindje të Tiranës. Tërheqje për turistët paraqet edhe shpella e Pirrogoshit që ndodhet në rrethin e Skraparit e cila përfaqëson edhe shpellën më të madhe në Shqipëri. Aktivitete tjetër argëtuesë është ciklizmi, i cili mund të zhvillohet në zonat e Alpeve sinë Theth, Vermosh etj. Por këtë aktivitet mund ta ushtrosh fare mirë edhe në Razëm. Një rol të rëndësishëm në këtë lloj turizmi luajnë edhe hanet apo bujtinat , ato janë struktura të vogla akomodimi me element tradicional, dhe janë kryesisht të përhapura në të gjithë Shqipërinë që përfaqësohet nga këto zona.

Këto struktura kanë egzistuar që nga perjudhat e vjetra dhe kanë vazhduar madje deri në gjysmën e parë të shek XX. Ato kanë luajtur rol të rëndësishëm në srehimin dhe ushqimin e njerzve dhe kafshëve kryesisht kuajve të cilët përbënin kalvare të gjata udhëtimi. Për zhvillim e këtij lloj turizmi është bërë edhe ushqimi tradicional mjaft i rëndësishëm. Kështu krijimi i staneve është kthyer tashmë në një domosdoshmëri. Ato janë të përhapura në të gjithë vëndin tone duke filluar që nga stanet të cilat ndodhen në Kukës, Theth Vermosh Dibër Mat Korçë Përmet e

Gjirokastër.

Shumllojshëria e aktiviteteve si dhe

larmishmëria e madhe bëjnë që ky lloj turizmi të ofrojë për turistët një produkt turistik mjaft të lakmuar. Por shfytëzimi dhe mirë organizimi i këtyre destinacioneve mbetet ende shumë larg niveleve optimale. Për të arritur një nivel më të lartë zhvillimi nevojiten pikë së pari shtimi inumrit të investitorëve, si dhe një infrastrukturë më e mirë.


Gjithashtu me rëndësi është dhe hartimi dhe zbatimi i politikave orjentuese për zhvillimin e kësaj dege mjaft të lakmuar të ekonomisë, e cila do të sillte mjaft të ardhura dhe zhvillim ekonomik .

Për tu arritur e gjitha kjo gjithashtu është e domosdoshme edhe një bashkëpunim i fortë midis banorëve të këtyre zonave si dhe qeverisjes qendrore.

### 3.1 Faktorët që ndikojnë në tërheqjen turistike të turizmit malor në vëndin tonë.

Është e nevojshme që të egzistojnë disa faktorë në mënyrë që zhvillimi i turizmit malor të jëtësia më i larmishëm dhe të pofësoj pothuajse të gjitha kërkesat e tregut potencial. Katër janë faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në tërheqjen turistike përkundrejt turizmit malor në Shqipëri.

Fig nr.3.1.1 Faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimi e turizmit malor.



#### 3.1.1 Burimet natyrore

Natyra malore në Shqipëri ndryshon nga ajo e zonave bregdetare sepse ajo mbetet ende ndër më të virgjërat në vëndin tonë. Malet zenë pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë dhe ato janë perfekte për zhvillimin e turizmit me ajrin e pastër, pyjet, lumenjtë dhe liqenet si dhe biodiversitetin e tyre. Pemët janë kritike për këto zona jo vetëm për ajrin e pastër por edhe për mbrojtjen e këtyrë zonave nga përbyttjet. Gjithashtu ato sigurojnë ambiente shplohëse për njeriun dhe janë të rëndësishme për kafshët e egra dhe një numur të madh produktesh druri. Shqipëria me sipërfaqen e saj të përgjithshme prej 28.748 km<sup>2</sup>, në përgjithësi është një vënd malor ku 70% e zënë malet, kodrat ,sipërfaqet e liqeneve dhe shtratete e lumenjëve. Përsa u përket pasurive ujore dhe potencialit hidro energjistik të saj ajo radhitete ndër vendet e para në Europë .Shqipëria është një vënd me reshje relativisht të shumta. Në zonat malore lumenjtë karakterizohen nga shtretër zallisitor apo shkëmbor duke formuar kanione shumë të thella me një bukuri tëvecantë që ngjall kureshtje e vizitorëve. Në këtë natyrë mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme si zytje në liqene të thellë e tëpastër , gjuheti , peshkim, hipizëm , agroturizëm , alpinizëm, ski etj.

### 3.1.2 Burimet kulturore

Ndër burimet kulturore më të rëndësishme përmëndim: trashigiminëurbane , artet, vlerat arkeologjike , traditat, artizanati etj.

Historia e trevave shqipëtare ka kaluar në shumë etapa pushtimesh dhe si e tillë ka huazuar stilet e pushtuesve por pa lënë mënjane edhe traditën e saj.

Traditat që prej kohës së ilirëve janë më mirë të ruajtura në zonat malore, si zona më me pak zhvillim e ndikim urban .Në historinë tonë kanë lënë gjurmë romakët , bizantinët , otomanët ,monarkia, pushtimi fashist, diktatura dhe perjudha më e fundit është ajo e pas viteve 1990.

Kultura shqipëtare ka ngjallur gjithnjë interesin e të huajve për shkak të traditave të pasura e të ruajtura deri diku me fanatizëm .Festata e vecanta nëfshat , menyra rurale e jetesës dhe afërsia me njëri tjetrin e njerëzve të zonave të vogla e të largëta i tërheqin së tepërmi të huajt drej një kulture të vecantë e dashamirëse ndaj cdo kujt . Elementët folklorik tepër të kuruar të traditës shqipëtare me veshjet e stolitëtradicionale , mbartin vlera të prekshme e dëshmi të kulturës sonë. Një element tjetër tepër i rëndësishëm për turizmin mbetet gatimi tradicinal i cili cilësohet nga të huajt si një shije e përzueshme për këdo .

### 3.1.3 Burimet sociale

Në këto burime bëjnë pjesëgjyha , kapitali financiar , shëndeti , aftësitë , mjedisi përreth si dhe komuniteti lokal i cili luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në këto zona. Shqipëria ka potencjale të mëdha ende të pa shfrytëzuara në burime sociale .

### 3.2 Vëndet në të cilat mund të zhvillohet turizmi malor në Shqipëri.

#### 3.2.1 Zona Theth Bogë Razëm.

Vlerat turistike të kësaj zone janë bërë të njohura që herët nga studjues tëhuaj si Pukvil Duhem etj të cilët e kanë cilësuar këtë zonë si një vënd me të vërtetë të bukur turistik. Në vitin 1879 ka filluar frekuentimi i zonës për turizëm , kryesisht gjatë stinës së verës nga franceskanët . Frekuentimi gjithnjë e më i shpeshtë sollti nevojën e ndërtimit të një rruge lidhëse dhe të bujtinave për pushuesit. Nga fundi i vitit 1945 ndërtohen për herë të parë kampe për pushuesit në Razëm dhe në Theth të cilët do të prisin pushues nga gjithë vendi në dimër dhe në verëderi në fillim të vitit 1990 . Mbas kësaj perjudhe është rritur inicjativa e lirë, e cila ka bërë të mundur rritjen për çdo vit të vizitorëve dhe grupeve turistike vëndas dhe tëhuaj .

Kjo zonë është një ndër më të pasura në vlera turistike për shkat të natyrës thujtse të virgjër dhe burimeve natyrore që ofron. Reljevi , klima , hidrografia dhe bimësia krijojnë një harmoni dhe kushte për zhvillim e turizmit në të katërta stinët . Razona përfaqëson një nga zonat turistike më karakteristike të Alpeve Shqipëtare dhe shtrihet gjatë pjerës jugperëndimore të tyre në një largësi prej 42 km larg qytetit të Shkodrës. Kjo zonë ka trajtën e një ballkoni natyror që sheh drejt Bratoshit Zagorës dhe Budishës. Reljevi malor i Razmës përmban në vetvete vlera të mëdha turistike dhe kuruese shëndetësore. Thethi shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës rreth 80 km larg tij .

Disa nga sportet të cilat mund të zhvillohen në këtë zonë janë :

1. Alpinizmi i cili aplikohet gjatë gjithë vitit por në muajt e dimrit kryesisht vetëm nga profesionistët pasi terreni është shumë i vështirë.
2. Sporti i gjuhëtisë . Larmia e kafshëve dhe shpendëve të egra në këtë zonë bën që ky sport të jetë i aplikueshëm si gjatë verës dhe gjatë dimrit.
3. Peshkimi. Gjuetia e peshkut ka si karakteristikë peshkimin e troftës dhe të mëlyshit
4. Garat me kuaj janë një

nga sportet të cilat mund të aplikohen më së miri në këtë zonë. 5. Ski. Të bërit ski mund të jetë fare lehtë I aplikueshëm në majat e Alpeve .

### 3.2.2 Lugina e Valbonës.

Lugina e Valbonës është një nga mbrekullitë e pa përsëritshe të natyrës alpine shqipëtare. Kjo luginë ndodhe në pjesën më verjore të vëndit në lindje të masivit malor të alpeve që përfshihet në rrethin e Tropojës. Lugina e Valbonës është zona turistike më e vizituar në rrethin e Tropojës, madje nga më të vizituarat në Alpet Shqipëtare pas luginës së Thethit. Kjo zonë me bukururi të rralla është e preferuar jo vetëm nga turistët vëndas por edhe nga turistët e huaj, të cilët parapëklqejnë të njihen edhe me zakonet dhe traditata e fshatrave më verjor të vëndit. Për të shkuar në Valbonë duhet të udhëtosh të paktën 7 orë nga kryeqyteti. Pjesa dërmuese e rrugës është aksi Tiranë –Bajram Curri , ku cdo turist ka mundësin të shijojë një udhëtim me target nëpër liqenin e Komanit.

Banorët e zonës tashmë e kanë kuptuar se turizmi malor me krijimin e mundësive në infrastrukturë, është një mbrekulli që u ka dhuruar natyra , e që duhet shfrytëzuar për të siguruar të ardhura . Ndërkoë , akomodimi ka ndryshuar dhe banesat janë përshtatut kushteve bashkëkohore .

Banorët që sapo kanë marrë nismën e mundësimit të turizmit familjar, kërkojnë tu jepet kredi nga shteti për restaurimin e banesave kundrejt projekteve që kanë paraqetur pranë organeve vendore .

Cdo vit numri ivizitorëve vëndas dhe të huaj ka pësuar rritje. Shtëpitë e banorëve janë të hapura për mysafirët , sic dëshirojnë ti quajnë turistët dhe vizitorët , banorët vëndas. Tashmëkullat janë restauruar dhe akomodohen vizitorët e shumtë që shkeiln Valbonën gjatë dimrit dhe vërës.

Ushqimi në këtëvënd është më tiparë të theksuara tradicjonale aty futen mish keci, qingji në hell, Troftë Valbonë , corbë , gjizë me specat djegës , qumësht mjaltë dhe djath deleje, flija –byrek është specjalitete , të gjitha këto produkte janë bio të prodhuara në zonë.

Sportet e ndryshme të cilat mund të zhvillonë në këtë zonë janë :

#### 1. Alpinizmi

Lugina e Valbonës ka një terren mjaft të pështacëm për zhvillimin e alpinizmit . Por nga ana tjetër vihet rre një mungesë e sigurisë për zhvillimin e tij. Në të ardhmen ndoshta këto kushte të

të jenë më të pështacme .Kjo pasi gjatëdimrit ,për shkak të dëborës terreni bëhet tepër I vështirë për tu përshkuar , pasi ai mbetet shumë tërheqës. Gjithashtu kjo zonë zotëron potencjale për të zhvilluar turizmin historic , bjologjik zoologjik , dhe etnografik.

## Voskopoja

Voskopoja vitet e fundit është kthyer në një ambient shumë i veçantë për turizmin malor. Pozita gjeografike e përshtatshme e ka shndërruar në një pikë të kërkuar jo vetëm nga turistët vendas, por edhe nga ato të huaj. Turistët një interes të veçantë shprehin jo vetëm për bukuritë natyrore dhe klimën e përshtatshme, por edhe për vlerat unike kulturore që fshihen në kishat, shtypshkronjën, si dhe në gërmadhat e objekteve të vjetra, ku fshihen vlera, kulturë dhe dije shekullore. Ndaj kjo qytezë që ka qenë vatër e qytetërim është më e preferuar kryesisht nga persona vip, të cilët vitet e fundit kanë preferuar që të festojnë Vitin e Ri në petkun e bardhë të borës.

Dhe të izoluar nga syri i kureshtarëve këtë e pohojnë vetë banorët, të cilët kanë shuar kureshtjen e të parit nga afër të personave të ekranit.Voskopoja është një vendbanim mesjetar i hershëm, që daton prej vitit 1330.Nga Shën Prodhomi hapet para vizitorit një pamje e mahnitshme, nga duken majat e Lënies dhe Ostrovica, me një lartësi prej 2246 metra.Lulëzimin më të madh Voskopoja e ka pasur në vitin 1764, atëherë kur popullsia e saj arriti në rreth 30 mijë banorë. Në atë periudhë kishte 25 kisha me afreske nga më të lakmuarat, ndërsa tani nuk kanë mbetur më shumë se 8 kisha.Në të njëjtën periudhë në këtë qytetërim ka pasur Akademi, Bibliotekë, Shtypshkronjë, 1720, artizanat të zhvilluar e tekstile.Ajo shërbeu si urë lidhëse jo vetëm brenda vendit, por edhe midis vendeve fqinje si Greqi e Turqi. Shkatërrimin e parë e ka pasur në vitin 1769, të dytin më 1789 dhe të tretin në 1916.Voskopoja ruan vlera të mëdha të artit mesjetar.

## Vlerat kulturore

Voskopoja është shënjestra e ithtarëve të kishave, qofshin restauratorë, qofshin vjedhës.Çdo vit ato nuk i shpëtojnë babëzisë së njeriut që kërkon të pasurohet duke shitur pronën e këtij qytetërimi të hershëm.Aktualisht në fshat kanë mbijetuar 8 kisha, që nuk mund të konsiderohen aspak në gjendje të mirë.Kisha e Shën Ilias është e dëmtuar dhe pritet që të merret në dorëzim nga një shoqatë franceze, për t'u restauruar.Këto objekte me vlera historike nuk i kanë shpëtuar as fatkeqësive të natyrës, motit të keq, lagështisë, shiut dhe dëborës që po i shkatërrojnë nga dita

në ditë kulturën disa shekullore që mbartin mbi supe. Me mbështetjen amerikane, si dhe interesimin e unionit francez “Patrimone Sans Frontiere” (Trashëgimi pa kufi), filloi restaurimi i kishave më 2003, që mund të vazhdojë edhe për 5 vjet të tjerë. Të vetmet ndihma të dhëna për këto kisha kanë qenë edhe fondet e kufizuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, apo të ndonjë shoqate tjetër.

#### Turizmi

Ish-Kampi i Pionierëve në këtë zonë është shndërruar prej disa vjetësh në pikën e vetme, ku mund të gresh kushtet e nevojshme për turizëm malor. Hoteli te ish-Kampi, me një vendndodhje mes pishash të shumta, është pagëzuar me emrin “Akademia”. Ndërtuar që në vitin 1954, vitet e fundit është restauruar duke i dhënë një stil unik, në harmoni me natyrën përreth, me një pistë në qendër të sipërfaqes së tij. Pika është e frekuentuar gjithmonë jo vetëm nga njerëz aktivë, që duan natyrën dhe sportet, por edhe nga vizitorë që çmojnë qetësinë dhe relaksin që ofron largësia e pikës nga pjesa tjetër e banuar. “Akademia” ka një numër të kufizuar dhomash, 28, që gjithmonë janë plot. Pushuesit nuk qëndrojnë shumë gjatë, por me periudha një javore. Hoteli ka parkim, kënd lojërash, kënd sportiv basketbolli dhe minifutbolli. Por mungesa e hoteleve e minimizon shfrytëzimin e sezonit të dimrit për banorët vendas. Ndaj jo rrallë banorët për të korrur fitime, lëshojnë me qira dhoma nga vilat e tyre. Kjo perlë natyrore ka nevojë për investim në hoteleri, shërbime, si dhe në infrastrukture .

#### Sportet dimërore.

Në dimër funksionon Pista e Skive dhe zhvillohen garat e famshme rajonale. Në të janë zhvilluar gjithmonë edhe kampionate kombëtare. Është një nga vendet e rralla ku mund të zhvillohen këto lloje sportesh dimërore, por ende mungon iniciativa për ta zgjeruar dhe çuar më tej turizmin alpin dhe sportin dimëror. Sporti I gjuhëtisë ka marrë një zhvillim të madh në këtë zonë , si një zonë e pasur me kafshë e shpendë tipike dhe të ralla. Ndër këto kafshëpërmëndim : ariun ,derri I egër, kaprolli dhia e egër, etj. Kurse në rsdhë e shpendëve dominues janë thëllëza dhe turtulli. Peshkimi ne lumen e Valbonës është kthyer në një sport tepër tëpreferuar nga vëndasit apo vizitorët. Peshku karakteristik I këtij lumi është trofta e Valbonës nga ku kjo e fundit ka marrë dhe emrin.

Fshati turistik I Dardhës Dardha është një fshat malor me , një bukuri e rrallë natyrore. 20 km në juglindje të Korçës, në një lartësi 1 344 m, Dardha ofron një klimë shumë të shëndetshme e ajër

të pastër. Sportet dimërore, sidomos skitë, tërheqin turistë të apasionuar pas tyre. Gjelbërimi dhe freskia e ditëve të verës, por dhe dimri me shumë dëborë, e bëjnë një vend të preferuar në të gjitha stinët e vitit. Midis burimeve të shumta në këtë fshat është edhe i quajtura “Uji i Qelbur”, që shërben si ujë kurativ për stomakun dhe veshkat. Shtëpitë e gurta, karakteristike, plotësojnë bukurinë e këtij fshati, por edhe njerëzit janë shumë mikpritës dhe gatuajnë specialitete karakteristike të fshatit. Fshati është relativisht i ri, nëse do të pranojmë të tillë kohën prej tre shekujsh që kur kemi të dhëna historike. Është themeluar e rritur prej të “ikurve”, rebelëve që përndiqeshin e kishin hesape me guvernën osmane, shpesh sepse nuk donin të ndryshonin fenë. Deri vonë, dardharët dhe fqinjët i quanin “ndardharë”. Dëshmia e parë historike der tani gjendet në Enciklopedinë greke Pirsos ku thuhet: “Në Dardhë, fshat shqiptar u hap shkolla greqisht më 1768. Nuk pritet të gjendet ndonjë e dhënë nëpër dokumenta më të hershme osmane si teftaret e taksave, sepse Dardha ka qenë gjithmonë fshat i lirë, i përjashtuar prej tyre. Studimi i arkitekturës së fshatit dëshmon për një model të veçantë të stilit evropian që haset edhe në fshatra të tjera të Jugut.

Parku Kombëtar I Malit të Tomorrit.

Malli I Tomorrit ndodhet 40 km në lindje të qytetit të Beratit. Pika më e lartë është 2416 m mbi nivelin e detit. Bukuritë natyrore janë të shumta si gropat, shpellat dhe rrënojat e kalasë pranë fshatit Tomorr.

Në këtë Park ndodhet edhe Tyrbja e Kulmakut ( Dervish Iljazi ) në një lartësi prej 1200 m dhe Tyrbja e Abaz Aliut në Cuk të këtij mali, ku çdo fund gushti këto vende të shenjta vizitohen nga mira pelegrinë, të cilët për një javë rresht, zhvillojnë ritet e fesë bektashije.

Gjinari turistik.

Në juglindje të Elbasanit shtrihet zona e Shpatit. Pjesa malore e kësaj krahine, që fillon nga shpati Shelcan e deri në Jeoronisht, quhet Shpati i Parë dhe përbëhet nga dy komuna: Gjinari e Zavalinë. Pika turistike Gjinari ( Fushkuqe 24 ha ) është shpallur e tillë me V.K.M.nr.5, dt.21.05.2001 por lidhja e saj me rrugë të asfaltuar me qytetin e Elbasanit 22 km, e bën shumë funksionale dhe të afrueshme për çdo turist. Sapo futesh duke udhëtuar në fshatin Derstilë, ndjehet aroma karakteristike, tipike e bushit që ndodhet mbi rrugë, dhe pas disa minutash, të shfaqet parasysh peisazhi i bukur me pisha, që sa më shumë i afroresh qendrës së komunës, aq më shumë bëhet piktoresk.

Ato që ia shtojnë bukurinë këtij relievi janë



sheshet (shpesh në formë grope) 900 – 1000m mbi nivelin e detit, të cilat sipas gjeografëve, janë krijuar para miliona vjetëve nga rrëshqitjet e vazhdueshme të akullnajave. Por Shpati nuk është vetëm një vend me natyrë të bukur, por këtu ka edhe shumë objekte me vlera historike e kulturore, që ia vlen t'i vizitoni gjatë udhëtimit tuaj.

### Parku kombëtar i Dajtit

I vendosur në lindje të kryeqytetit Dajti është një nga 15 parqet kombëtare të Shqipërisë, . Parku zë një sipërfaqe prej 3300 hektarësh dhe është destinacioni më i frekuentuar ditor i kryeqytetasve por edhe i vizitorëve të shumtë.

Vera në Dajt është e freskët dhe dimri është i ftohtë, kryesisht me dëborë. Temperaturat gjatë dimrit arrijnë edhe në minus. Reshjet janë të bollshme gjatë të gjithë vitit, por kryesisht në pranverë dhe në vjeshtë. Në të katër stinët e vitit, natyra prezanton një spektakël të vërtetë në parkun e Dajtit.

Tarraca detare e Dajtit. Ndodhet 1000 m mbi nivelin e detit, në shpatin perëndimor të malit të Dajtit, Brenda Parkut Kombëtar. Është e gjatë rreth 2 km dhe e gjerë 600-800 m. formon fushë me livadhe e pyje ahu përreth.

Vizitohet me teleferik Tiranë-Dajt 14 minuta, ose sipas rrugës Tiranë-Dajt. E veçanta e bimësisë së parkut nuk është vetëm shumëllojshmëria por edhe shtresëzimi. Flora fillon me shkurret, vazhdon duke u ngjitur në lartësi me dushkun dhe përfundon me ahët 200-vjeçarë dhe halorët. Pisha e bredha të lartë zbukurojnë majën e malit si gjatë dimrit të mbushur me dëborë, ashtu edhe gjatë stinëve të tjera të mbushura me gjelbërim. Ndonëse tashmë me një numër të kufizuar, fauna e parkut është e larmishme. Brenda pyllit strehohet ariu i murrmë, ujku, dhelpra, derri i egër, lepuri i egër, macja e egër etj.

### Aktivitete dhe sporte të ndryshme

Maja e malit të Dajtit është 1600 m mbi nivelin e detit. Në shpatet e tij të pyllëzuara rriten mjaft kafshë të egra.

Kështu ju mund të ushtroni sportin e gjuetisë gjatë sezonit, mund të bëni ski në dimër, mund të ngjiteni malit, të bëni ekskursione, kamping, etj. Të gjitha këto aktivitete do ta pasurojnë më tepër qëndrimin tuaj në Dajt.

### Teleferiku

Ka disa vite që në Malin e Dajtit ju ofrohet një shërbim mjaft komod dhe i këndshëm, ai i

transportit me teleferik, nga rrëza e Dajtit e deri në majë të tij.

Vizitorët mund ta përshkojnë rrugën ajrore të Dajtit vetëm për 15 min, duke paguar një biletë prej 700 lekë të reja për të rriturit dhe 400 lekë për fëmijët. Në këtë rast ata paguajnë edhe shijimin e një panorame të mrekullueshme që u ofron zona.

Kuzhina dhe akomodimi

Dajti ofron një strukturë të mirëfilltë turistike, si për turizmin ditor ashtu edhe për llojet e tjera të tij. Përgjatë rrugës së Dajtit dhe në zonën e tij turistike janë ndërtuar një sërë hotelesh e restorantesh, që mirëpresin pushuesit dhe vizitorët. Kushtet e hoteleve dhe komplekseve turistike janë moderne dhe shumë të rehatshme, të pajisura me shërbime të shumta.

Elementët tërheqës të turizmit malor janë hanet dhe stanet .

Hanet apo bujtinat , janë struktura të vogla me arkitekturë tradicionale , të cilat kanë qënë të përhapura në të gjithë teritorin e Shqipërisë. Këto struktura kanë egzistuar që nga perjudhat e vjetra dhe kanë vazhduar deri në gjysmën e parë të shek XX .Ato kryenin funksjonet e akomodimit , fjetjes dhe ushqimit për udhëtarët e ndryshëm vëndas apo të huaj . Po kështu edhe funksjonet e strehimit dhe të ushqimit të kuajve për udhëtarët dhe karvanet e ndryshme që leviznin në atë perjudhë kohe. Sot duke jetuar në kohët modern dhe në një perjudhë globalizimi, turistët janë të prirur në kërkim të origjinale dhe të asaj e cila mbetet e vecantë . Në këtë kontekst duhet të përmendim edhe projektin e “ 40 Haneve “ të ndërmarë nga ana e Ministrisë së Turizmit , Kulturës , Rinisë, dhe Sporteve . Ky project synon shfrytëzimin e këtyre strukturave të vjetra të Shqipërisë , në menyre që ato të pështaten si struktura akomoduese për turistët.

Objektivi kryesor I këtij projekti është zhvillimin I turizmit të qëndrueshëm duke shfrytëzuar bukuritë natyrore dhe kulturët e këtyre zonave .Shërbimet që ofrohen në këto hane janë shumë të mira akomodimi juaj mund të jetë një relaks i vërtetë.

Turistët mund të akomodohen në dhoma plotë me dritë dhe shtretër komodë, dhe një ushqim bio me produkte të zonës .Përvec këtyre i zoti i shtëpisë të ofron shoqërimin në mal ose shëtitje në vëndet më piktoreske të zonës.

Po kështu diversifikimin e ofertës turistike nëpërmjet formave të ndryshme të turizmit sic janë , agro-turizmi, eko-turizmi, turizmi kulturor ai malor etj.

Stanet . Për zhvillimin e turizmit malor ,kohët e fundit stanet janë shndëruar në një domosdoshmëri për vlerat e pa imagjinushme që mbartin. Këto stane janë të përhapura në të

gjithë vëndin tonë duke filluar që na stanet e mbrekullueshme të Kukësit, përreth Valbonës Thethit dhe Vermoshit. Traditë të vecantë kanë stanet në malet e Dibrës dhe të Matit , të cilat përvec funksjonit të tyre kryesor ,mbarështimi I bagëtive në stinën e verës , vizitoheshin nga banorët e zonës të cilët qëndronin së bashku me barinjtë për të shijuar natyrën dhe ushqimin e shëndetçëm tradicjonal të zonës.Vecorite e këtyre staneve qëndron në faktin se ato përdoreshin edhe si vënde kurimi për personat që vuanin nga turbekulori apo sëmundje të tjera.

Për të njëjtat vlera përmenden stanet në malësinë e Mirditës dhe të Pukës. Stane të cilat frekuentohen gjërësisht , janë ato në malësinë e Krujës dhe në malësinë e Tiranës , jo vetëm për shkak të ajrit të pastër por edhe për afërsinë e tyre me kryeqytetin.Një mbrekulli e vecantë janë edhe stanet në malet e Korcës , Devollit, Përmetit dhe Gjirokastrës .

### 3.3 Parqet kombëtare dhe natyrore si vlerë e pa zëvendësueshme për turizmin .

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vëndin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë.Këto zona mbrohen nga shtetei dhe numurohen rreth 384 të tilla. Fillimet e zonave të mbrojtura kanë nisur që në 1940 me shpalljen e Parkut Kombëtë të Malit të Tomorrit në Berat , dhe krijimin e rezervat të parë shtetëror të gjuhëtisë Kune –Tale në Lezhë.

#### 1.Parku kombëtar I Thethit

Thethi është park zoologjik natyror në afërsi të Shkodrës 70 km nga ky qytet. Ai është I mrojtur nga tre male Radohima – Sheniku – Papluku me lartësi mbi 2500 m mbi nivelin e detit. Lugina e Thethit është një nga zonat më të vecanta të këtyre alpeve , 750-950 m mbi nivelin e detit me një sipërfaqe 2630 hektarësh.

#### 2.Parku kombëtar I Valbonës .

Lugina dhe njëkohësisht Parku Kombëtar I Valbonës ndodhet në një distancë prej 25 deri 30 km nga qyteti I Bajram Curit . Parku ka një sipërfaqe prej 8000 hektarësh .Ajo zë një pjesë të konsiderushme të alpeve lindore .Edhe lumi I Valbonës përfshihet në këtë park dhe për nga bukuria e tij mund të konsiderohet si një prej lumenjëve më të bukur të Shqipërisë

#### 3.Parku kombëtar I Lurës

Ky park shtrihet në malesin e Lurës dhe zë një sipërfaqë prej 1300 ha .Malet e Lurës kanë drejtim veri jug dhe ngrihen në 2250 m .Territori I këtij parku është shumë I thyer.Bukuri e kësaj zone janë dhe liqenet e saj.Liqenet e Lurës janë liqene akullnajore. Gjithsej në këtë aonë ndodhe 12 liqene . Ndër to përmendim Liqenin e Madh , Liqenin e Ri , Liqenin e Lopëve , Liqenin e Luleve etj.

#### 4.Parku Kombëtar I Steblevës .

Duke analizuar potencjalin natyror dhe trashigimin kulturore të zonës mud të themi se kjo zonë ka destinacion turistik që mundëson zhvillimin e disa tipeve të turizmit.Kjo zonë përben një vënd pritës poli funksjonal ku egzistojnë disa fakteore që I tërheqin vizitorët që të lëvizin drejt saj. Nga pikpamja kohore e shpërndarjes së flukseve kjo zonëështë dy sezonale ajo mund të shërbejë si qëndër turistike për zhvillimin e turizmit për sportete dimërore , dhe si qëndër turistike për turizmin klimaterik vereor .Stërbleva ndodhet në qarkun e Elbasanit, 20 km larg qytetit të Librazdit.Kjo zonë së fundmi ka marrë një zhvillim në saj të fondacionit Sorros.

#### 5.Parku Kombëtar Zall Gjocaj.

Ky park ndodhet rreth 40 km në very lindje të qytetit të Burrelit, në Krahinënë Malore Qëndrore , në një teren kryesisht malor. Lartësia shkon nga 600 deri 2000 m mbi nivelin e detit. Pamja është tepër piktoreske , larg qëndrave të banuara me burime të shumta natyrore dhe një reljev të larmishëm.

#### 6. Parku Kombëtar I Qafshamës

Zona e mbrojtur ka sipërfaqe prej rreth 20 km<sup>2</sup>, e shpallur e tillë prej vitit 1966.Ajo gjendet rreth 25 km në verilindje të qytetit të Krujës. Gjith vona dallohet për vlerat natyrore dhe pyjet e virgjëra .Gjithashtu burimet e saj janë të njohura për vlerat kuruse, ku dallohet kroji I Nënës Mbretëresh në të cilën është ndërtuar një fabrika e ujit Qafshama.

#### 7.Parku Kombëtar Bredhi I Hotovës.

Ky park mund të cilësohet pa asnjë dyshim mushkëria natyrore e Shqipërisë jugore. Ai ndodhet në zonën e Frashërit , rreth 35 km nga qyteti I Përmetit në verilindje të tij. Me një shtrirje prej

1200 ha dhe një masiv të mbrekullueshëm të përbërë kryesisht nga bredhi maqedonas , ky park është një nga perlat turistike të Shqipërisë , që ofron surpriza të këncme në cdo stinë të vitit.

#### 8.Parku Kombëtar I Dajtit

Parku I Dajtit ka një sipërfaqë 293.8 km<sup>2</sup> , duke përfshirë këtu edhe gjithë pellgun ujëmbledhës të Bovillës . Ky park dallohet për vlera të larta të biodiversitetit dhe për vecoritë natyrore dhe të pejsazhit .Brënda sipërfaqes së këtij parku janë dhën leje për ushtrimin e veprimtarive ekonomike disa subjekteve .Kjo subjekte duhet të jenë gjithnjë nën kontroll për të siguruar zbatimin e planit të manazhimit të parkut.Mënyrat për të arritur janë me teleferik ose në rrugë automobilistike.

#### 9.Parku Kombëtar Bredhi I Drenovës

Ky park shtrihet në kurizin e malit të Moravës rreth 10 km nga qyteti I Korcës . Sipërfaqja e tij është 1380 ha , pika më e lartë është maja e Rrumbullakut 1783 m mbi nivelin e detit.Ky park ka burime të shumta natyrore por ai është I pasur edhe me pasuri hidrike si burimi i Shëngjergjit ,Plakes ,Ariut etj.

#### 10.Parku Kombëtar Mali I Tomorrit.

Mali I Tomorrit ndodhet 30 deri 40 km në lindje të qytetit të Beratit . Pika më e lartë është 2415.7 m mbi nivelin e detit bukuritë natyrore janë të shumta , si gropa shpella të cilat kanë dhe legjendat e tyre .Përvec bukurive natyrore ky mal quhet edhe si mali I shënjtë sepse në një lartësi prej 1200 m ndodhet Tyrbja e Dervish Iljazit dhe në Cukë Tyrbea e Abaz Aliut.

11.Parku Kombëtar Llogara .Llogaraja është park dhe përfaqëson një nga vëndet më të bukura të Shqipërisë .Me sipërfaqën prej 1020 ha .Ajo është e mbuluar me gjelbërim të përhershëm. Ajo konsiderohet si një vënd klasik I vendosjes së ekuilibrit bjologjik midis botës bimore dhe asaj shtazore .në brëndësi të pyjeve të saj gjënden burime të shumta natyrore dhe pikërisht në një nga pjesët më të bukura të saj është ngritur qëndra e saj turistike .

Qëndra turistike e Logarsë është e njohur që në vitete e komunizmit. Ajo ishte e organizuar me gabina të vogla ku vinin të apasjonuarit pas natyrës.

#### 12.Parku Kombëtar Prespë.

Sipërfaq e parkut përfshin tokëbuqësore , pyjore kullota, livadhe dhe sipërfaqe ujor ndërkohë zona më me përparësi për zhvillimin e turizmit është vija bregliqenore. Parku I Prespës ndodhet në juglindje të Shqipërisë , në kufi me Maqedoninë dhe Greqinë. Prespa në vitin 2000 u shpall park ndërkombëtar.

### 13 . Parku Kombëtar I Mavrovës .

Ky park përfshin shpatet jugore të malit të Sharit, një pjesë të malit të Korabit si dhe maleve të Deshatit . Kjo sipërfaqe relativisht e vogël karakterizohet nga një numur I madh majash mbi 2000 m të larta .Pika më e lartë është ajo mbi malin e Korabit që përfaqëson pikën më të lartë në Maqedoni edhe në Shqipëri me një lartësi 2764 m . Këto maja janë vecanërisht të bukura dhe përfaqësojnë mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit .Parku përmban monumente kulturore si Manastiri I Shën Gjonit I ndërtuar në 1020 dhe I rindërtuar në vitin 1743 ku gjendet një iconostas I rallë.Pasuri tjetër janë dhe punimet artizanale.Parku ka një zyrë turistike e cila punon për promovimin e rajonit, monitorimin e aktiviteteve turistike, marketingun e produkteve locale dhe organizimin e eskursjoneve dhe aktiviteteve të tjera turistike.Turizmi dimëror po njet vitet e fundit një zhvillim të madhe duke ofruar paketa turistike mjaft ekonomike.

Shpellat janë një tjetër atraksjon turistik

Kuliti I gurit , I shpellave I shkëmbinjëve , është I lidhur me natyrën e mistershme të këtyre objekteve ,është I lidhur dhe me rolin që ato kanë luajtur në jëtën e shoqërisë , si mjete si vegla, si vënde qëndrimi e banimi të njerëzve para historicit. Shpellat përbëjnë një interes të vecantë nga pikpamja turistike

#### 1.Shpella e Jubanit ,Shkodër

Ndodhet rreth 300 m afër fshatit Juban , komun Vau I Dejës . E formuar nga karsti në gëlqeror me degëzime ende të pa njohura .Galeria kryesore është mbi 100 m , ka disa zhgjerime e mikroforma tërheqëse .Mund të vizitohet me rrugën Shkodër –Guri I Zi –Juban.

#### 2.Shpella e Vali Mirditë

Kjo shpellë ndodhet në lindje të fshatit Perlat në komunën Kthell në Mirditë.Si njësi natyrore ajo është pjesë e sistemit të bjeshkëve të Selitës, Mulli , Dille , Valmor me lartësi 1300 deri 1500 m

mbi nivelin e detit. Vlerat kulturore në nivelin e një monumenti të këtij lloj dhe pejsazhi mahnitës përbëjnë vlera për industrinë e turizmit. Ajo është mjaft e vizitueshme nga shkollat e zonës .

### 3. Shpella e Akullit në Mirditë

Kjo shpellë gjendet në mes të Breshtës së Oroshit në Mirditë dhe ka histori me këtë masiv të stërmadh malor . Të futesh brënda kësaj shpelle është aventurë, gjithsesi nëse hyn brënda vëren rreth 7 m dëborë të brezuar poshtë , ndërsa më pas në një kthin shpelle fshihen akullnaja në forëm stalagtidësh dhe stanlgmentësh që janë një mbrekulli e rrallë.

4. Shella e Kaurit Pukë  
Mbit ë tatëpjetën thikë që zbret në brigjet e liqenit të Komanit në Pukë , ndodhet një prej shpellave më të vecanta në Shqipëri , përse i përket historisë së saj

Historia e saj e cuditshme zë fill në kohën e pushtimit nga otomanët e që lidhet me fenë , bëri që askush nga banorët e fashatit Buzhal e Qelzës të mos flisnin për të . Ky vendstrehim natyror e që të mahnit me misteret e saj u bë i njohur vetëm 7 vjet më parë . Vitet e fundit shpella e Kaurit ka befasuar shumë të huaj dhe ajo që i habit më shumë është fakti se në këtë shpellë shekuj më parë banorët katolik të zonës turreshin të fshiheshin në labirinthe të saj për ti shpëtuar ndërimin të fesë .

### 5. Shpella e Pëllumbasit Tiranë

Mendohet të këtë qënë një nga shtëpitë më të hershme të paraardhësve tanë , mijra vjet më parë . Në atë hapsirë që paraprihet nga një koridor i gjatë e që vazhdon me një salon të lartë 15 deri në 20 m , ata kanë ndezur zjar kanë gatuar kanë punur veglat e para të punës. Këtë e tregon materjali i bollshëm arkeologjik i gjetur në fazën e parë të gjermimeve i cili i përket perjudhave të ndryshme të zhvillimit njerëzor.

Kjo shpellë ndodhet 22 km larg kryeqytetit në afërsi 2 km në verilindje të fshatit Pëllumbas . Kjo shpellë i përket perjudhës pre historike dhe është një nga 6 shpellat karstike që gjenden në Europë , duke paraqitur vlera shkencor , arkeologjike, kulturore dhe turistike.

### 6. Shella e Pirogoshit Skrapar

Kjo shpellë zbulon një fakt të hamendësuar por shumë afër të vërtetës sipas të dhënave që në viset shqipëtare mund të jëtë ndezur zjarri i parë në Evropë ose Shqipëria të këtë qënë një ndër vëndet e para të kontinentit ku është ndezur zjarr. Kjo shpellë ndodhet në Skrapar disa km larg

qytetit të Corovodës . Kjo shpellë është një mbrekulli e vërtetë natyrore . Hyrja e shpellës është madhështore stalaktidet dhe stalakmidet në brëndësi të saj janë gjigande .

7. Shpella e Trenit Korçë Kjo shpellë ndodhet në buzë të liqenit të Prespës së vogël , përfund një kodre të vogël pranë fshatit Trend he është 706 m mbi nivelin e detit . Reljevi është kodrinor dhe përreth shpellës malor . Banorët e njohin me emrin si shpella e ujkut . Ka disa galeri por më e madhja është ajo e liqenit 40 m I gjatë dhe 5.5 e gjerë . Pasuritë ujore, pyjet e dendura, kafshët e egra dhe fusht pranë saj ishin kushtet kryesore që kushtëzuan vendosjen e banorëve prehistorik në këtë shpellë. Kafshët e egra dhe fushat pranë saj ishin kushtet kryesore që kushtëzuan vendosjen e banorëve prehistoric në këtë shpellë.

### 3.4 Përse turizmi malor është më pak i zhvilluar se ai bregdetar.

Turizmi malor, është shumë i brishtë për t'u zhvilluar, krahas turizmit të plazhit dhe atij kulturor, është segmenti, që aktualisht ka dhënë shenjat e tij pozitive të zhvillimit, pavarësisht se janë ende në nivele të ulta. Nëpërmjet turizmit sigurojnë të ardhura për një jetë më të mirë të banorëve që jetojnë atje.

Shembull pozitiv është ai i Thethit, ku komuniteti lokal (deri tani 20 familje) i ka shndërruar banesat e tyre karakteristike në "Guesthaus" dhe presin çdo vit një numër të madh turistësh. Vitin e kaluar këtë vend e vizituan më shumë se 7,500 turistë, ndërsa këtë vit edhe më shumë.

Domethënës është fakti që këtu edhe struktura e turistëve është ajo e synuara, pasi 80-90% e turistëve janë të huaj, nga të gjitha vendet europiane e ato të kontinenteve të tjera. Kjo tregon se turistët vendas dynden në zonat bregdetare duke mos njohur degët e tjera të turizmit dhe njëri prej tyre është turizmi malor.

Shqipëria nuk ka vetëm Thethin, Valbona ka njohur gjithashtu zhvillime pozitive me të njëjtin lloj turizmi. Përveç Alpeve Shqiptare, janë Lura, Korabi, Puka, Stebleva, Voskopoja, Dardha, Vithkuqi, Prespa edhe mjaft fshatra apo krahina të tjera, që pa diskutim duhet të jenë pjesë e hartës turistike ndërkombëtare e për to duhet treguar vëmendje më e madhe.

Qeveria i ka përqendruar investimet e saj të infrastrukturës në zonat me përparësi bregdetare cka ka sjellë edhe rritjen e numrit të turistëve në këto zona ndërkohë që Thethi vazhdon të mos ketë furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike apo rrugë, si dhe të qëndrojë akoma për rreth gjashtë muaj i bllokuar , pasi rrugët nuk pastrohen nga bëbora e madhe që pllakos këtë zonë. Të njëjtat probleme kanë edhe zonat e tjera malore.



Ja përse zonat bregdetare janë sot më të preferuara nga turistët vendas për pushime sesa zonat malore:

1. Infrastruktura në zonat bregdetare është e mirë krahasuar me ato të zonave malore në të cilat në të shumtat e rasteve rruga zgjatet nga nga 2 deri në 4 më shumë për shkak të këtij problem. 2. Njësitë akomoduese në zonat bregdetare janë më të shumta pasi niveli I investitorëve është mjaft I madh kjo sjell kapacitete mjaft të mëdha akomoduese , ndërkohë që zonat malore kanë investime të pakta në këtë fushë dhe për shkak të kësaj të fundit mund të mos kesh mundësi të akomodoesh në pikun e sezonit. 3. Afërsia me qytetet kryesore të cilat janë të mbipopulluara I ofron turizmit bregdetar më shumë mundësi për të thithur turistë .

4. Shërbimi është më profesional në zonat bregdetare duke filluar që nga nivelet e larta dhe deri në ato më të ulta .

5. Mungesa e shërbimeve plotësuese si ndihma e shpejtë mjekësore e bëjnë turizmin malor më pak të frekuantuar sesa atë bregdetar. 6. Marketingu i bërë nga njësit akomoduese të vendosura në bregdet e bëjnë më të njohur këtë pjesë të Shqipërisë sesa pjesën malore , në të cilën promovimi është ende në nivele të ulta.

Edhe pse shumë turistë vijnë në Shqipëri për zonat malore (që fatmirësisht, si pasojë e aksesit të pakët, janë relativisht të pastra), shumë të tjerë shkojnë në bregdet. Por shumë zona të bregdetit në Shqipëri kanë ndotje bakteriale disa herë sipër normave të lejuara dhe kjo sigurisht që nuk i bën mirë turizmit. Nga ana tjetër, siç përmenda, Shqipëria ka ende është disa zona gati të virgjëra natyrore, të cilat për turistët që vijnë nga vendet e zhvilluara janë shumë tërheqëse. Këto zona gjenden përgjithësisht në pjesën malore të vendit, ku aksesit për njerëzit është më i vogël, ndaj edhe kanë arritur t'i rezistojnë ndotjes. Këto zona duhet të mbahen të tilla në mënyrë që të tërheqin turistët e huaj apo vendas . Shumë turistë vijnë për natyrën e egër dhe është shumë e rëndësishme që natyra të mbahet e pastër dhe të zhvillohet ekoturizmi, në mënyrë që mos ta humbim edhe këtë potencial që kemi. Turizmi malor nga ana tjetër zotëron cilësi të shumta krahasuar më atë bregdetar : 1. Natyra e virgjër dhe për pasojë shumë më e pastër sesa zonat bregdetare.

2. zhvillimi I industrisë në zonat bregdetare shkaktojnë ndotje në mjedis dhe jo vetëm , kjo gjë është shumë e pakët në zonat malore për të mos thënë që nuk egziston.

3.Prodhimi si dhe shijimi I ushqimeve bio është I mundur vetëm në zonat malore .

4.Një nga cilësitë e banorëve në zonat malore është mikpritja gjë që në zonat bregdetare është zbehur.

5.Në nivele të përgjithshme të bërit pushime në mal është më pak e kushtueshme sesa ato në bregdet.

6.Mbi popullimi I zonave bregdetare në sezonin veror shkaktohet shurma të nivelit të lart cka shkakojnë pakënaqësi të turistët ndërkohë që zonat malore nuk e kanë këtë problem.

Shfrytëzimi pa kriter I burimeve të ndryshme turistike të ndodhura në zonënëbregdetare , do të bëjnë të mundur që në një të ardhme jo shumë të largët turizmit të dretojnë vëmëndjen e tyre në të bërit e turizmit në zonat malore, të cilat duhet gjithashtu edhe të mbrohen nga një zhvillim I madh për një perjudhë të shkurtër ashtu sic po ndodh me zonat bregdetare .

### 3.5 Turizmi malor në Shqipëri përballë konkurentëve.

Mund të zgjidhet Thethin, Voskopojën, Dardhën apo Razmën për zhvillimin e turizmit malor..Për të apasionuarit pas sportit të skive mund të merrni shërbime nga profesionistë në ture si në malin e Jezercës apo Korabit.

Institucionet promovuese të turizmit shqiptar thonë se janë bërë përmirësime në infrastrukturën e disa zonave malore, ndërkohë që me ligj garantohen lehtësi fiskale, si përjashtimi nga taksat për tetë vjet për çdo investim që kryhet për këtë qëllim.Dëborë, ski, shëtitje në mal, gatime tradicionale janëato çfarë vëndi yne ofron për pushime dimërore. Përvec destinacjoneve brënda vëndit turistët shqipëtar preferojnë të zgjedhin për të bërë pushime dimërore në vëndet fqinje si Maqedonia dhe Mali I Zi.

Paketat turistike së fundmi janë bërë joshëse, me çmime ekonomike, për shkak edhe të krizës ekonomike që po bëhet më e ashpër.

Fqinjët kanë rritur agresivitetin dhe lufta për ofertat “loë cost” është e fortë.

Maqedonia ka prezantuar kohët e fundit për shqiptarët një fushatë marketingu joshëse.

Por turizmi dimëror vendas nuk duhet të bëjë llogari me konkurrencën që vjen nga jashtë, pasi në të vërtetë ajo është e pamundur.Ekspertët dhe operatorët e tregut flasin për turizëm që është në fillesa, që nuk ka një produkt të mirëfilltë, që zhvillohet në mënyrë individuale dhe që pothuajse

nuk promovohet. Nga ana tjetër, institucionet promovuese të turizmit shqiptar thonë se janë bërë përmirësime në infrastrukturën e disa zonave malore. Këto nuk janë problemet e vetme, pasi është edhe ai i mungesës së statistikave për këtë segment turistik. Nuk dihet se sa është numri i vizitorëve që shfrytëzojnë destinacionet dimërore që ofron jo vetëm natyra, por edhe biznesi privat në Shqipëri.

Ajo që mund të themi me siguri është se alternativat argëtuese nuk mungojnë, madje ato janë me çmime ekonomike. Një turist mund të kalojë natën në një dhomë alpine me 15 euro, me ngrohje me dru dhe ushqim tërësisht bio.

Ky lloj turizmi është në hapat e parë dhe është aq sporadik sa që nuk mund të flitet për një produkt të kristalizuar, duhet ende shumë punë për krijimin e strategjive, ndjekjen e tyre në mënyrë permanente, dhe promovimin e tyre. Duhet të bëhen studime rreth efekteve që mund të kenë faktorë të ndryshëm mbi këtë degë të turizmit. Destinacione kryesore të turizmit malor, ku ka disa zhvillime dhe investime të bizneseve private, janë : Voskopoja, Dardha , Llogoraja, Thethi, Valbona, Razma dhe mali i Dajtit.

Në këto zona, ofrohet kryesisht vetëm thjesht akomodim dhe ushqim , cka e bën një product turistik jo të kompletuar . Këto struktura kanë mungesa të argëtimit brenda dhe përreth qendrës. Mungojnë lehtësitë e nevojshme si pishinat e mbyllura ato të turizmit të shëndetit, banjat turke, sauna, ambientet sportive, ato të kalimit të kohës së lirë si skitë, boëling, fusha tenisi, minigolfe, bilardo etj. Të gjitha këto do ta plotësonin këtë produkt, do ta bënin më konkurrues me alternativat e tjera turistike në vend, por edhe me produktet e ngjashme në rajon. Në Shqipëri, akomodimi në struktura që ofrojnë turizëm malor ka çmime të ndryshme në varësi të investimeve që janë bërë. Një turist mund të gjejë çmime shumë ekonomike (10 euro fjetja dhe mëngjesi i përfshirë) nëse zgjedh të qëndrojë në shtëpitë e banorëve vendas (guesthouse), si në Theth, Valbonë, Voskopoje.

Më tështrenja janë njësitë akomoduese hoteliere që ofrojnë shërbime cilësore në Dardhë, Razëm apo Llogora. Ky lloj turizmi preferohet kryesisht nga vendasit, për shkak se ky produkt ka ende nevojë që të plotësohet, për të qenë konkurrues me vendet e tjera të rajonit. Ai ka nevojë edhe për shumë marketing që të bëhet i njohur. Ka përmirësime në infrastrukturë në disa zona, siç është rruga e Voskopojes, Valbonës (e cila është hapur, por nuk është asfaltuar), ajo e Razmës dhe e Llogorasë, por është e nevojshme që këto rrugë të ngrihen në standardet përëndimore dhe të mirëmbahen ,sepse ato përdoren më shumë gjatë dimrit, kur edhe kushtet atmosferike janë më të vështira dhe mbi të gjitha të hapen dhe shtrohen rrugët që të çojnë në

destinacionet e tjera të bukura të vendit, si në Lurë, Vermosh, mali i Tomorit në Skrapar, Përmet etj.

Por ne ende nuk kemi investuar në pista skish. Shteti duhet të luajë rol shumë të rëndësishëm në stimulimin e këtyre investimeve, por edhe në promovimin tek investitorët që shprehin interes në këtë fushë .

E në këto kushte, vështirë të thuhet se po konkurrojmë me vendet fqinje, deri-diku ndoshta vetëm me çmimin. Vendet fqinje ofrojnë jo vetëm turizmin malor të relaksit me të gjitha facilitetet, por edhe atë malor aktiv, ku mbizotëron turizmi i bardhë apo ai i skive.

Turizmi shqiptar promovohet shumë pak në përgjithësi dhe pa një strategji të caktuar, kurse turizmi malor si produkt i ri edhe më pak. Pushteti qëndror nisi të vlerësojë këtë turizëm me nismën që mori për të hequr të gjitha taksat, për ata që do të investojnë në turizmin malor. Kjo sjell në vëmendje e rëndësisë që ka zhvillimi i këtij turizmi te ne, ku dy të tretat e sipërfaqes janë zonë malore.

Zhvillimi i këtij segmenti me anë të stimujve fiskalë, por pa përgatitur më parë një strategji (ku të përcaktohet qartë se çfarë dhe si duhet të zhvillohet) mund të ketë efekte negative, siç mund të jetë zhvillimi kaotik që ka ndodhur në zonat bregdetare.

Prezenca e disa hoteleve , si në Razëm, Voskopojë, Dardhë, Llogora etj., është e ulët për ta përkufizuar këtë si turizëm dimëror shqiptar. Duke parë numrin e vogël të hoteleve dhe infrastrukturën jo të përshtacme , shqiptarët për të bërë turizëm dimëror preferojnë vendet fqinje. Krahasimi me vendet fqinje si Maqedonia apo Kosova është pothuajse i pamundur e po kështu, mund të thuhet edhe për konkurrencën. Secili nga vendet fqinje me Shqipërinë, përfshi edhe Kosovën ka mbi dy qendra skish të pajisur me infrastrukturë të plotë, si në hoteleri ashtu dhe në impiante. Për të mos folur më pas për një traditë turizmi dimëror të vërtetë, mbi 30-vjeçare, e konsoliduar tashmë. Prej vitesh ne nuk konkurrojmë, por vetëm furnizojmë fqinjët me klientë dhe të ardhura.

Nëse flasim për turizëm dimëror në Shqipëri, në të vërtetë bëhet fjalë për restorante dhe hotele, që sigurojnë ngrohje dhe kushte për të pritur turistë gjatë dimrit.

Ky nuk është turizmi dimëror i ditëve të sotme, kur pushimet duhet të jenë të larmishme dhe dinamike.

Nevojiten projekte të mëdha për ngritjen e stacioneve të mirëfillta të skive, që do të mundësonin ekzistencën e turizmit dimëror në Shqipëri me standarde europiane. Pavarësisht mungesës së tyre ne vazhdojmë të promovojmë malet shqiptare brenda dhe jashtë vendit . Operatorët e turizmit

flasin për një turizëm malor që është kryesisht sporadik, institucionet që merren me promovimin e kësaj fushe flasin për potenciale të pashfrytëzuara dhe për masa që po merren për nxitjen e tij. Për Agjencinë Kombëtare të Turizmit, Shqipëria ofron një sërë mundësish për të shfrytëzuar këtë lloj turizmi dhe vit pas viti, situata ka ndryshuar në favor. Sipas drejtuesve të institucionit, infrastruktura është përmirësuar, në disa zona rrugët janë rehabilituar dhe kjo ka ndihmuar në shkurtimin e distancave. Një tjetër avantazh që ata rendisin është edhe vendimi që ka marrë qeveria për të lehtësuar nga barra fiskale investimet në zonat malore. Për drejtuesit e AKT-së, Shqipëria po synon të ofrojë një sezon turist të shtrirë gjatë gjithë vitit dhe kjo po garantohet edhe nga disa avantazhe.

Infrastruktura që është duke u përmirësuar (rehabilitimi i rrugëve, furnizimi me energji elektrike e ujë) po krijon destinacione të reja, që nuk ishin të arritshme më parë. Nga ana tjetër, përjashtimi nga taksat krijon avantazhe konkurruese për investime të reja, jo vetëm nga banorët lokalë, por edhe të huajt. Avantazh tjetër është diversiteti natyror, ushqimi bio, traditat dhe zakonet që i bëjnë të dallueshme zonat malore. Pozita gjeografike që ka vendi jep mundësinë e arritjeve të destinacioneve në kohë të shkurtër. Nga ana tjetër, ne konkurrojmë, me çmime të favorshme. Akomodimi, ushqimi dhe transporti kanë kosto të ulët për turistët.

Por krahas këtyre avantazheve, Shqipëria nuk mund të konkurrojë dot e vetme përballë shteteve fqinje që gëzojnë jo vetëm përvojën e gjatë, por edhe infrastrukturë moderne dhe cilësore. Për Agjencinë Kombëtare të Turizmit, rajoni po bashkëpunon duke konkurruar. Kjo nënkupton se një turisti të huaj, me anë të projekteve konkrete, i mundësohet qëndrimi disaditor, në destinacione të ndryshme rajonale, në mënyrë që ai të përfrtojë vizita të efektshme të njihet me kultura dhe shërbime të ndryshme. Ajo që pranohet edhe nga zyrtarët është se mungesa e investimeve të natyrës së turizmit malor, si qendrat e skive apo resortet, po bëhen shqetësim për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij turizmi. Përhapja e gjerë e peizazheve malore, të cilat zënë dy të tretat e sipërfaqes së vendit, bën që të ofrohen mundësi të shumta për veprimtari turistike, të cilat zhvillohen në këto zona.

Zona kryesore për zhvillimin e sporteve dimërore është pika malore e Voskopojës, në Korçë. Këtu gjendet “pista e skive” ku zhvillohen edhe garat e kampionatit kombëtar.

Sportet dimërore mund të zhvillohen në zona si Razma, Boga, Thethi, Shishtavec, Grabova, Dardha, Biza etj. Trekingu dhe ngjitjet malore zhvillohen kryesisht në vargun e Çikës, por edhe në zonën e Kurveleshit. Itinerari më interesant do të ishte Dukat-Tërbaç-Vranisht-Kuç-Kudhës-Qeparo. Për këtë lloj aktiviteti mund të

shfrytëzoni edhe pika të tilla si Vermoshi, Thethi, Razma, Boga, Valbona etj. Mali i Tomorit i shtrirë në rrethet e Beratit dhe Skraparit, Vithkuqi, Voskopoja, Drenova në Rrethin e Korçës, Guri i Kamjes në Rrethin e Pogradecit, Llogoraja në Rrethin e Vlorës, Korabi e Radomira në Rrethin e Dibrës, Gjinari në Rrethin e Elbasanit, lugina e Drinos në zonën e Dropullit në Rrethin e Gjirokastrës, itinerari Borsh-Zhulat që përshkon Kurveleshin etj. Në lumenjtë dhe përrrenjtë e shumë malorë, peshkimi sportiv është një kënaqësi më vete. Zonat më të përshtatshme me bukuri natyrore për këtë lloj aktiviteti janë lugina e Valbonës, përroi i Thethit, lumi i Shalës në Alpet Shqiptare, lugina e sipërme e Vjosës etj. Aktivitet tjetër argëtues janë biçikletat malore, të cilat mund të zhvillohen në zonën e Alpeve (Theth, Vermosh) etj. Kur të gjithë janë duke vuajtur efektet e krizës ekonomike, shtetet fqinje si Mali i Zi dhe Maqedonia po rrisin përpjekjet për të thithur sa më shumë turistë, me paketa ekonomike. Për muajt e dimrit, parashikohet që të huajt të shpenzojnë mbi 200,000 net qëndrime. Shteti fqinj verior, numëron 32 hotele në resortet e skive, të cilat kanë kapacitet të akomodojnë mbi 2,000 persona. Ndërkohë që në Shqipëri kapacitetet akomoduese të turizmit të zhvilluar në stinën e dimrit janë ende të vogla dhe nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e turistëve,

#### 4.1 Historiku I Thethit.

Historia e Thethit është e lidhur me atë të fisit ilir të Labeatëve. Në shek VIII kjo zonë ishte pjesë e pultit .Ky vënd për herë të parë shfaqet I dokumentuar në defterin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës. Në vitin 1485 me emrin fusha dhe në atë kohë kishte vetëm 7 shtëpi të mëdha .Në shek XVI turqit e izoluan këtë zonë nga Shkodra dhe Malësia e Madhe duke e bashkuar administrativisht me sanxhakun e Dukagjinit me qëndër në Pejë . Që nga ajo kohë Thethi konsiderohet si pjesë e Dukagjinit . Më pas në fillim të shek XIX fisi I Ahcajve nga Thethi arriti të bashkojë këtë zonë me Bushatllinjtë e Shkodrës .Në 1892 u ngrit kisha e Thethit.Në vitin 1921 e gjen Thethin me shkollët të ndëtuara nga Kryqi I Kuq Amerikan , dhe më pas në 1936 hapet rruga automobilistike që shoqërohet një vit më vonë me hapjen e një agjensie turistike.Viti 1966 zona e Thethit shpallet Park Kombëtar me vendim të këshillit të ministrave.Me kalimin e viteve që nga viti 1968 e në vazhdim do të hapen disa qëndra të tjera turistike dhe do të ndërtohen godina , hotele e shumë objekte të tjera që do të prisnin vizitorë të shumë nga e gjithë Shqipëria dhe Europa Lindore për 35 vjet rresht . Kapaciteti I sezonit veror ishte mesatarisht deri në 600 vetë dhe në dimër ai reduktohen deri në 400 .Pas ndryshimeve të viteve 90 hoteli funksionon

vetëm pjesërisht me një kapacitet prej 30 shtretërisht dhe është privatizuar. Më vonë u rritën aftësitë akomoduese. Bukuritë e pa përsëritshme të këtij fshati malor në zëmër të Alpeve Shqipëtare e bëjnë atë që të zërë një vënd të rëndësishëm në natyrën dhe turizmin shqipëtar. Duke u nisur nga vecoritë e tij dhe nga vendodhja pranë kufirit Parku Kombëtar I Thethit është propozuar që të jetë pjesë e një parku ndërballkanik të quajtur Parku I Paqes, ku të përfshihen teritore edhe nga Kosova dhe Mali I Zi.

#### 4.1.1 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore.

Parku Kombëtar I Thethit ndodhet në pjesën qendrore të Alpeve të Shqipërisë, ndërmjet bllokut të Bjeshkëve të Namuna në perëndim dhe bllokut të Jezercës në lindje. Thethi është një qendër turistike alpinistike më e rëndësishme e zonës verjore. Ajo ndodhet 70 km larg qytetit të Shkodrës. Parku kufizohet nga të gjitha anaët me maja të larta shkëmbore të cilat bien thikë mbi luginë dhe formojnë pamje të pa përsëritshme si maja e Radoimës, asaj të Arapit etj. Ky fshat piktoresk shtrihet në lartësin 750 deri në 800 m. Parku ka klimë të ashpër në dimër me rreshje dëbor që shkojnë deri në 1.5 m në pjesët e ulta dhe deri në 3 m në pjesët e larta. Ky park është kompleks me larmi bimësh ku pjesën më të madhe e zënë pyjet e ahut. Në park rriten 1500 lloje bimësh të cilat përfaqësojnë gati gjysmën e florës në vëndin tonë.

Thethi Parku zoologjik natyror.

Quhet I tillë nga banorët dhe vizitorët për ka një hapsirë të admirushme e cila ofron kushte të mira jetese disa llojeve të ndryshme të kafshëve të egra si ariu dhia e egër dëri I egër kaprolli dhe lëpra ujku lepur i iriqi etj. Por përveç shumëllojshërisë së kafshëve të egra pylli është I pasur edhe me shpendë të ndryshëm si shqiponja skifteri thëllëza pëllumbi I egër gjeli I egër dhe shpendë të tjerë të cilët janë shtegëtarë gjatë sezonit të riprodhimit. Nuk duhen lënë pa u përmendur edhe pasuritë e lumit të Shalës, të Kaprës pa harruar dhe liqenin e akulltu të Tërthores ku gjenden lloje të ndryshme peshqish.

4.2 Vlerat turistike të Thethit Vlerat e këtij vëndi më shumë se kushdo tjetër I kanë vëndë në dukje vizitorët e huaj. Një kontribut të rëndësishëm për njohjen e këtyre vleradhe kanë dhënë organizatat e huaja si GTZ dhe UNPD. Nisma e tyre fillon në radhë të parë në investimet minimale në ifrastrukturën e kësaj zone. Përveç bukurive natyrore pejsazeve dhe pamjeve të

vecanta të krijuara të gjitha nga natyra, pa ndërhyrjen e njeriut , ky vënd ofron një sërë aktivitete si peshkimi, noti , ciklizmi, kanoe, alpinizëm , parashutizëm etj . Gjithashtu është për tu vlerësuar ushqimi I freskët dhe I shëndecëm bio që ofrojnë banorët e kësaj zone.Kjo zonë mbart mbi vete histori , gojdhëna dhe legjenda që në shek XIII të cilat përbëjnë një interes të madh jo vetëm për turistët e huaj .Pasuritë natyrore janë të shumta si : 1. Kanioni I Grunasit I cili është 2 km I gjatë 40 deri në 60 m I thellë dhe vetëm 2 deri në 3 metër I gjerë . Po këtu gjenden një numur I konsiderueshëm shpellash të cilat kanë tërhequr vëmëndjen e shumë alpinistëve dhe gjeografëve .2. Një bukuri natyrore të vecantë shpalos në këtë zonë ujvara e Thethit me lartësi 25 m , ku së bashku me cirqet përreth dhe mullirin e Blojës formojnë një nga vëndet më interesant për tu vizituar . Por jo më pak tërheqës është dhe vënd burimi I lumit të Shalës në Okol , burimet e të cili vënë në punë një hidrocentral të vogël dhe 12 mullinjë që shërbejnë për ujë të pishëm .

Pasuritë kulturore gjithashtu janë mjaft të rëndësishme ato janë :1. Kulla e ngujimit . Në këtë kullë janë pajtuar mbi 300 gjaqe nga I gjithë Bajraku I Shalës . Kjo kullë ka mbi katër shekuj që është ndërtuar dhe është përdorur për pajtimin e dy palëve .Kur një person kryente një vrasje kishte të drejtë të merte pleqtë për të pleqëruar ngjarjen . Plaku lunate rolin e avokatit të palës që zhgjidhte , I akuzuari kishte të drejtë të qëndronte I ngjuar brënda Kullës për 15 ditë , ku brënda këtij harku kohor ishte kohë e mjaftushme për të gjetur mbrojtjen e tij dhe të sjaroheshin rrethanat e kryerjes së vrasjes . Kjo kullë nuk ka funksjonin si kullat e tjera të zakonshme sipas kanunit që mbizotëron në këtë vënd , sipas të cili autorët e vrasjeve ngujoheshin për të gjithë jetën . Kjo kullë ndryshe nga të tjerat është përdorur për të kryer kuvende të cilat do të conin në pajtimin e gjaqeve .

Kete vënd e kane mbajtur gjalle tre binjakezime1. Kanuni I Lek Dukagjinit qe kishte ndikim ne te gjite krahinen2.Besa qe palet I jepnin njeri tjetrit  
3.Feja katolike, ku besonin banoret e Dukagjinit gjë që ka ndihmuar në bashkimin e banorve pasi ishin te gjithë të të njëjtës fe.

Kjo kullë u ndërtu nga të parët e këtij vëndi për mbrojtjen e Thethit dhe konsiderohej një relike për krahinën e cila vizitohet me kureshtje nga cdo turist .Kulla ka rreth një shekull që nuk epërdor funksjonin e saj parësor , pra për zhvillimin e kuvëndeve pasi kjo traditë është zbehur dhe lënë mbas dore dhe tani ajo shërben si muze. Kjo kullë është me tre kate . Ne katin e pare



qendronin roje te armatosura,ne katin e dyte qendronte personi qe kishte kryer krimin bashk me pleqt ne pritje te zgjidhjes se problemit.Edhe ne katin e tret qendronin roje te armatosur. Kulla gjate sezonit turistik eshte e hapur si per turistet vendas dhe te huaj,dhe personi I cili ben rolin e ciceronit ishte I aftë dhe dashamires me turistet.Muzeu etnografik është një ndërtesë e vecantë e cila është e vendosur në një majë shkëmbi me lartësi 9 m . Nga ana etnografike kjo zonëështë një minjerëari , ku në të futen veshjet karakteristike të zonës, për burrat këmisha e gjatë me xhamadanin prej shajaku dhe për gratë tipar dallues është xhublejat . Banesat karakteristike me një zgjighe të thjeshtë të ruajtura me fanatizëm janë një vlerë e vërtetë etnografike .Muzeu ndodhet në një gjëndje të mjerueshme dhe nuk kishte ndonje person per te ber shpjegimin e kesaj ndertese dhe te historis qe ajo mbart.Kisha e Thethit është e vetnja kishë në këtë zonë e ndërtuar që nga viti 1892 . E gjithë zona karakterizohet nga besimi I njëjtë katolik gjë që ka ndihmuar në mbajtjen sa më të bashkuar të banorëve .Rikonstruksjoni i saj është bërë vitete e fundit me ndihmën e emigrantëve të këtij vëndi në Amerikë.Veprimtaritë e shumta të cilat mund të zhvillohen në këtë destinacion janë :

1. Shëtitje dhe marshime nga Thethi cdo turist mund të shëtisë me ndihmën e një udhërrëfyesi nëpër rrugë kalime të mbrekullueshme për ditë të tërra .
2. Pëshkimi dhe noti . Në Theth gjenden disa vënde të mbrekullueshme për të peshkuar e sidomos troftën e lumit një nga vëndet e pështacme për peshkim është ura e Kolajve dhe ura e Gërles gjithashtu këto vënde janë të favorshme edhe për zhvillimin e sportit të notit
3. .Ciklizëm malor . Thethi është një nga zonat e përfshira në itinerarin e turnout të ciklizmit malor . Rruga që kalon nga Kopliku në Theth dhe përgjatë lumit të Shalës dhe të Kirit dhe që përfundon nëShkodër ,është një nga pejsazet më të bukura që do të kënaqte cdo ciklist I cili ka interest ë shohë , bukuritë natyrore dhe që I pëlqejnë sfidat . Pra Thethi zotëron terene të tilla të cilat I ofrohen edhe personave që individualisht duan ta praktikojnë këtësport .
4. Alpinizëm . Vitetet e fundit ky vën është vizituar shumë nga alpinistë nga vënde të ndryshme të europës të cilët kanë ardhur në Theth thjesht për të bërë alpinizëm dhe një pjesë për të eksploruar shpella të ndryshme si dhe për të zbuluar të reja.
5. Kanoë dhe kajak . Ky sport mund të zhvillohet shumë mirë gjatë perjudhë së pranverës dhe vjeshtës , kur lumenjtë e këtij vendi janë të mbushur dhe të rëmbyer nga shkrirja e dëborës dhe shirave .

6. Sportet e ajrit . Në Theth mund të gjenden zona të pështacme për të apasjonuarit pas sporteve të ajrit. Pra në këtë zonë mund të praktikohet edhe sporti I parashutizmit duke e shijuar nga një tjetër këndvështrim bukuritë e rralla të kësaj zone.
7. Gjuhëtia .Larmia e kafshëve dhe shpendëve të egra në këtë zonë bën që edhe ky sport të aplikohet. Krijohen kushte për këtë veprimtari si gjatë verës ashtu edhe përgjatë dimrit

Përvec sporteve te ndryshëm Thethi ofron mundësi të shumta për të zhvilluar turizmin shkencor I cili ndahet në disa nën degë . Turizmi shkencor është një lloj I vecantë I turizmit I zhvilluar kryesisht në vitete e fundit I cili gjen terren të pështacëm për aplikim në zonën e Thethit .

#### 1.Turizmi shkencor gjeografik .

Larmia e objekteve gjeografike si majat e ndryshme të kësaj zone si ajo e Veleçikut , e Kunorës , e Radohimës , e Arapit . Lugina si ajo e Thethit e Shalës luginat akullnajore si ajo e Përoit të Thatë.Q afa si ajo e Thorës , Pejës , Drenit etj. Por edhe format e reljevit si kanioni I Grunasit paraqesin interes shkencor .

#### 2.Turizmi shkencor gjeologjik.

Karakteristikat gjeologjike të zonës , me depozitime të mesozoit kenozoit dhe mbizotërim të depozitimeve të kuaternarit dhe thyerje tektonike tërthore e aferogjtësore kanë një interes të vecantë studimor.

#### 3.Turizmi shkencor historic.

Faktet historike tregojnë se popullsia e zonës ka qënë pjesë e luftrave të vazhdueshme me Turqinë , Sërbinë ,Malin e Zi etj.Njohja e shkëmbimeve kulturore apo ndikimi ndikimi I këtyre luftrave në mëndësinë e këtyrë banorëve , ekonominë dhe turizmin e vëndit përbëjnë një factor të rëndësishëm studimoro shkencoro-historik.

#### 4.Turizmi shkencor arkeologjik.

Evidentimi I vëndbanimeve apo qëndrave prehistorike si Shpella e Skeletit , Shpella e Madhe , dhe një sërë objktesth e qëndrave të tjera me interes arkeologjik ofrojnë mundësi të shumta studimi .

#### 5.Turizmi shkencor etnografik .

Nga ana etnografike kjo zonëështë një minjerë ari .Përmëdim veshjet karakteristike të zonës

për burrat këmishë e gjatë më xhamadnin prej shajaku dhe për gratë xhubleta. Banesat karakteristike me një stil arkitektonik dhe dekorativ që ruan traditat me fanatizëm janë një vlerë e vërtetë etnografike .

#### 6. Turizmi shkencor biologjik dhe zoologjik .

Në zonën e Thethit dallohen mbi 4 lloje bimësh endemike dhe mbi 25 lloje bimësh sub endemike .Përmëndim një sërë bimësh tipike të zonës ,zambaku shqipëtar ,Vjollca e Dukagjinit , Kamil Qyqja ,Bishtmini lulevogël etj. Kjo llojshmëri e tillë bimësie ngjall interes të vecantë për biologët .Dukeqënë se zona është thuasje e pa prekur kemi edhe një shumëllojshmëri kafshësh e shpendësh tipik të zonës . Kafshët dhia dhe dërrri I egër ,ujku dhelpra ,lepuri dhe macja e egër etj. Shpendët thëllënxa e malit , shapka , pëllumbi I egër , mëllenja ,gushkuqi ,etj.

#### 6. Turizmi shkencor speologjik.

Në zonën e Thethit vihet re një ndarje e larmishme e shpellave karstike sepse territori nga ana litologjike është I ndërtuar kryesisht nga karboidratet. Shpellat më me interes nga ana turistike janë : Shpella e majës së Arapit e gjatë 13 km dhe e ndërtuar në formë galerish me shumë kate dhe me tre sifona të mëdhenj ,sjo qëndron e lagët gjatë gjithë vitit, Shpella e Qafës së Pejës është një pus karstik I thellë 102 m , shpella e Skeletit në Vishnje është një vendbanim pre historic me vlera jo vetëm turistike por edhe shkencore ,shpella e Akullit është një pus I madh karstik I cili qëndron I mbushur me akull gjatë gjithë vitit ,shpella e majës së Velecikut është në formë pusi dhe ka një thellësi prej 28 m ,shpella e Gjek Markut ka origjinë akullnajore dhe një thellësi 232 m me pozicionin vertical për shkak të karakteristikave të saj ajo mund të vizitohet vetëm prej spleologëve .Shpella t mund të vizitohen nga kategori të ndryshme turistësh duke qënë se shkalla e vështirësisë së frekuentimit të tyre është e ndryshme .

#### 4.3 Problematikat që hasen sot në zhvillimin e turizmit në kësaj zone .

Megjithëse potencialet janë të shumta në Theth në të gjitha drejtimet këto potenciale nuk mund të shfrytëzohen nëse nuk investohet në përmirësimin e kushteve të Thethit të vogël por me vlera të mëdha , I cili ka hidrocentral por nuki ka drita ka turistë por nuki ka kushte , ka rrugë port ë shkatëruara , ka pyje por edhe druvar me motorshara ka terren të pështacëm për ski por

mungojnë pistata dhe teleferikët , ka zona shumë të mira për ciklizëm malor por nuk ofrohen bicikleta me qera , ka banorë shumë mikpritës por që kanë problem në komunikim me turistët e huaj .

Disa nga problemet kryesore janë:

1.Mungesa e infrastrukturës . Ky është një nga problemet kryesore që shoqëron zonën e Thethit. Shpesh herë turistët detyrohet të ecin në këmbë për të aritur në destinacion për shkak të mungesës të infrastrukturës ose të rrugëve të këqija gjithashtu një problem tjetër është edhe ai i mungesës së sinjalistikës ( sinjalistika është e vendosur vetëm brënda fshatit) .

2.Mungesa e energjisë elektrike . Ky problem i jep kësaj zone një disavantazh për zhvillimin e turizmit . Është e pa pranushme që në afërsi të kësaj zone të gjendet një hidrocentral dhe kjo zonë të vuaj nga mungesa e energjisë .

3. Mungesa e qendrave shëndetësore është një disavantazh për këtë zonë pasi përbën një problem real për zonënë . Në rastin e ndonjë fatkeqësie apo aksidenti banorëve do ju duhet të udhëtonin për orë të tëra për të shkuar në qytetin më të afërt e për tu mjekuar .

4.Vështirësia e banorëve për të komunikuar me të huajt. Banorët mbartin një vlerë të pa diskutueshme që është mikpritja por nga ana tjetër ata kanë vështirësi në njohjen dhe komunikimin në gjuhë të huaj për turistët të cilët janë jo shqipëtar .

5. Shkatërimi i pyjeve është me të vërtetë një problematikë e cila kërkon vëmendje të menjëhershme nga shteti i cili duhet të caktojë personat përkatës për ruajtjen e këtyre pyjeve.

6.Mungesa e guidave turistike , nga ky fakt shpesh herë turistët marrin përsipër të kryejnë vetë udhëtimin edhe pa e ditur mjedisin dhe vështirësitë apo reziqet që mund tu krijohen .

4.4 Analiza swot e turizmit në Theth. Analiza swot është e domosdoshme pasi në të shpalose elementët kyç të cilët ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në zhvillimin e turizmit në këtë rast në Theth.

Tabela nr.4.4.1 Analiza swot e turizmit në Theth.

|               |                |
|---------------|----------------|
| Pikat e forta | Pikat e dobëta |
|---------------|----------------|

|  |   |
|--|---|
| 1.Pejsazhe të shumta                         | 1.Mungesa e qëndrave shëndetësore   |
| 2.Asete të shumta historike dhe kulturore    | 2.Mungesë ifrastruktore.  |
| 3.Zonë ende e virgjër.                       | 3.Mungesa burimeve njerëzore të<br>specjalizuara.                         |
| 4.Flora dhe fauna e pasur                    | 4.Mungesa e një plani të qartë për zhvillimin e<br>turizmit në këtë zonë. |
| 5.Pasuri natyrore të shumta.                 |   |
| 6.Ruajtja e vlerave dhe traditave kulturore. |   |

Faktorët e jashtëm janë të ndarë nëdy grupe në mundësit dhe në kërcënimet.

| Mundësitë  | Kërcënimet                        |
|--|-----------------------------------|
| 1.Avantazh konkurrues me çmime të mira e peizazh të pacenuar | 1.Kriza ekonomike                 |
| 2.Krijimi I një turizmi të larmishëm jo vetëm atij malor.    | 2.N umur I pakët investitorësh.   |
| 3.Ruajtja dhe mbrojtja e medisit si një aset I vecante.      | 3.Mungesa e një djalogu politik.  |
| 4.Zhvillimi I turizmit rural dhe agroturizmin.               | 4.Moszbatim I ligjit të turizmit. |
|  | 5.Turizëm jo I qëndrueshëm .      |
|  | 6.Globalizimi .                   |

Cdo element negative qoftë nga pikat e dobta dhe nga kërcënimet kërkon një vëmëndje të vecantë nga pushteti qëndror local dhe vetë komuniteti.Pasi të tre këta element janë përfituesit e drejtpërdrejt të përfitimeve që sjell zhvillimi I turizmit në këtë zonë.Sigurisht që për të përmirësuar këto element kërkohet një shumë financjare e konsiderueshme që për hirë të së vërtetës nuk është e disponushme për tu investuar në këtë sector.

Pavarësisht elementëve ende të pa plotësuar Thethi është një destinacion mjaft I frekuentur , e sidomos nga të huajt të cilët përbëjnë edhe pjesën më të madhe të vizitorëve , mos ndoshta kjo tregon se ne ende nuk njohim dhe shfytëzojmë pasurit tona ?Dhe nqs është një gjë e tillë realitet atëhere elementi kryesor I cili do të bënte të mundur njohjen do të ishte promovimi I cili , I cili për hir të së vërtetës mbetet ende në nivele minimale

#### Rekomandimet

1.Duhet ruajtur me kujdes tradita dhe kultura duke ruajtur origjinalitetin e shtëpive alpine , kullave ,rikonstruksjonin e atyr të vetrave apo ndërtimin e të rejave në shërbim të turizmit dhe jo

ndërtimin e hoteleve pa një projek urbanistik të zonës ,pavarësisht nga fuqia ekonomike e investitorit

2. Komunat në zonat malore duhet të hartojnë strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe të mbështeten me financime dhe investime ,për tju përgjigjur më mirë ofertës turistike .

3.Duhet ngritur një strukturë në shkallë vëndi të grupit të Task-Forcës ( e mbështetur ligjërisht ) për parandalimin dhe mbrojtjen e dëmtimit të pyjeve dhe të faunës .

4.Duhet të kontrollohet dhe minimizohet gjuhetia ilegale pasi janë në zhdukje shumë specje të ralla.

5.Duhet bërë investime të vazhdueshme sidomor në rrugët që të cojnë në zonat malore dhe mirbajtja e tyre gjatë stinës së dimrit.

6.Duhet bërë kujdes me cmimet pasi në disa raste janë tepër të larta si për restorantet ashtu edhe për njësitë akomoduese.

7.Është I domosdoshëm prania gjatë gjithë kohës e një ekipi mjekësor.

8.Ndërgjegjësimi i komuniteteit për vlerat turistike potencjale egzistuese, në këto vënde.

9.Duhet të ndërtohen pistat e skive .

10. Promovimi I këtyre zonave duhet të jëtë I vazhdueshëm .

11.Nxitja e agro-turizmit dhe turizmit familjar .

12.Duhet të plotësohet paketa turistike me facilitate të tjera ndihmëse.

Përfundime

Ekonomia e liberalizuar dhe hapja me botën , krijojnë kudhte për tërheqjen e turistëve të huaj dhe vëndas. Për këtë duhen investime , për të krijuar mjedise e kushte të nevojshme si rrugë, telekomunikacion ndërtimi I pikave e mjediseve shplodhëse , ngritja e njësive të shërbimit , kulturë profesionale etj.Kjo do të bëjë të mundur një të ardhme turistike me shumë perspektivë për vitet që do të vinë .

#### Zhvillimi I zonave

malore duhet të bazohet në hapsirat dhe mundësitë qëjanë , për një veprimtari të caktuar . Duke patur parasysh të gjitha zonat turistike malore mund të konsiderohet se për vetë natyrën e saj përbën një fond natyror për zhvillimin e turizmit . Për një ecuri të mëtejshme duhet bërë kujdes me këtë bukuri të natyrës të ruajtur deri tani. Vëmëndje e madhe duhet për zonat e gjelbërta .Investimet mund të bëhen në këtë zonë duke ruajtur traditën dhe duke e përshtatur me zonën turistike malore.Egziston një numur I konsiderueshëm I kullave shumë prej të cilave janë lënë në mëshirë të fatit dhe një varg objektesh të tjera të rëndësishme për historinë dhe kulturës shqipëtare. Mos restaurimi I këtyr objekteve është një humbje e madhe për kulturën por dhe për të ardhmen , pasi ruajtja e trashigimisë kulturore është një nga prioritetet e strategjisë së zhvillimit.

Duhet filluar me ndërtimin e infrastrukturës në shumëzона dhe kjo të pështatet me mjedisin e këtyre zonave. Të gjitha këto mundësi që kanë zonat për zhvillimin e turizmit mund të themi se në të ardhmen do të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin e këtyre zonave do të bëhet e mundur mos shpërngulja e popullsisë si dhe rikthimi I shumë të larguarve , duke pasur një të ardhme më tësigurt me zhvillimin e turizmit.Duke analizuar potencialin natyror dhe trashigiminë kulturore mund të themi se këto zona me destinacion turistik , mundësojnë zhvillimin e disa tipeve të turizmit. Nga pikpamja kohore e shpërndarjes së flukseve këto destinacjone janë dy sezonale .

Atom und të shërbejnë si qëndra turistike për zhvillimin e turizmit për sported dimërore dhe si qëndër turistike për turizmin klimzterik veror.Tashmë janë shtuar ndjeshëm vizitorët turistik , drejt turizmit malor të cilët përdorin për struktura akomoduese hanet dhe bujtinat , gjë e cila përbën për turistët një eksperjencë të vecantë . Një mundësi tjetër zhvillimi në këto zona paraqet dhe agro-turizmi I cili mund të zhvillohet në forma tëndryshme .

Ekoturizmi mund të gjenerojë në të vërtet të ardhura të larta për ekonominë locale dhe rajonale . Kjo degë e turizmit kombinon kënaqësinë e zbulimit , e përjetimit të florës dhe faunës me mundësinë për të kontribuar për ruajtjen e tyre .Ai ka si objektiz kryesor sturdimin admirimin e

përjetimin e pamjeve natyrore në rastin tonë në zonat malore . Gjithashtu një vëmëndje e vecantë duhet ti kushtohet objekteve fetare pasi shumë kasha të vjetra dhe objekte fetare të besimeve të ndryshme janë akoman nënë rënoja në të gjitha këto vënde .

Përparësi kanë marrë hanet dhe bujtinat me arkitekturë tradicionale të lakmueshme për turistët duhet vënë në funksjon shumë hanë të vjetra të cilat do të jenë një kontibut për zhvillimin e turizmit malor në të gjithë vëndin .

Mungesa e infrastrukturës ( rrugë . pista skish ,etj ) I detyrojnë turistëtë vëndas të kryejnë pushimët dimërore në vëndet fqinje si Maqedoni apo Mali i Zi.



Bibliografia



A.Dibra V. Baku "Zhvillimi I turizmit në rajonin e Shkodrës relaiteti dhe perspektiva " Shkodër Idromeno 2000.

Rifat Talani , Xhevat Kraja : Razëm-Bogë -Theth , "Camaj -Pipaj" Shkodër 2000.

Gëzim Uruci "Historia e speologjisë shqipëtare " Shkodër 2003 .

Christian Zindel Barbara Hausammann " Thethi dhe Kelmendi guidë për ecje malore" Tiranë Toena, 2010 .

Mexhit Zogu "

Maxhun Dida , Nihat Dragoti , Gjon Fierza " Zonat e mbrojtura natyrore parqet kombëtare të Shqipërisë " Tiranë 2003 .

Dr.Edmond Kadiu "Ekonomi turizmi" Tiranë 2011.

ëëë.[fioritravel.com](http://fioritravel.com)

ëëë.[akt.gov.al](http://akt.gov.al)

ëëë.[alpetshqipetare.com](http://alpetshqipetare.com)

ëëë.[ata.org.al](http://ata.org.al)

ëëë.[albania-guide.com](http://albania-guide.com)

